



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 48 (827852)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 8 dhjetor 2023

111 vjet Ushtri Shqiptare



**Presidenti i Republikës së Shqipërisë
sh.t. z. Bajram Begaj**

“Në këtë ditëlindje të 111-të të tyre ne përulemi, nderojmë dhe jemi mirënjohës për shërbimin, kontributin dhe sakrificat e të gjithë efektivëve që kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura!”



Kryeministri i Republikës së Shqipërisë Edi Rama

“Në 111-vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura Shqiptare, efektivët tanë janë mishërim i përkushtimit ndaj sigurisë, lirisë dhe interesave të kombit tonë.”



**Ministri i Mbrojtjes
Niko Peleshi**

“111 vite nga krijimi i Forcave të Armatosura! Mirënjohje të thellë për të gjithë efektivët dhe personelin e angazhuar, të cilët janë të dedikuar që Forcat e Armatosura të jenë simboli më i mirë i forcës dhe përkushtimit ndaj sigurisë, lirisë dhe të interesave të kombit tonë.”



**Shefi i Shtabit të Përgjithshëm,
gjeneralmajor Arben Kingji**

“Të nderuar oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe punonjës civilë të Forcave të Armatosura, kam nderin dhe kënaqësinë që t’ju përcjell urimet e mia të përzemërta me rastin e 4 Dhjetorit, Ditës së Krijimit të Forcave të Armatosura!”

Ministri Peleshi dhe gjeneralmajor Arben Kingji pritën atashetë ushtarakë të Republikës së Turqisë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji pritën në një takim kortezie kolonel Muhamet Kelami Kablay, me rastin e përfundimit të detyrës si atashë ushtarak i Republikës së Turqisë, i akredituar në vendin tonë, si dhe kolonelin Tolga Kip, i sapo emëruar në këtë detyrë.

Gjatë takimit gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi përpjekjet dhe punën e kolonel Kablay-it, për rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes, gjatë kohës së qëndrimit në detyrë.

Gjithashtu gjeneralmajor Arben Kingji i uroi suksese në detyrën e sapo marrë kolonel Kablay-it, duke e garantuar për gatishmërinë e FARSH-së në thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve e veçanërisht në fushën e arsimimit ushtarak, në modernizimin e FARSH-së, ku asistencë turke ka qenë domethënëse në rritjen e kapaciteteve të emergjencave civile si dhe në modernizimin me pajisje luftarake të ndërveprueshme të reparteve të deklaruar në NATO. Nga ana e tij kolonel Kablay, pasi shprehu kënaqësinë dhe mbresat gjatë qëndrimit si atashë ushtarak në Shqipëri, falënderoi gjeneralmajor Arben Kingjin për mbështetjen e dhënë në kryerjen e detyrës.



Kolonel Tolga Kip, në cilësinë e marrësit të detyrës, siguroi gjeneralmajor Kingjin për vijimin dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën ushtarake mes

dy vendeve. Në përfundim të takimit, gjeneralmajor Arben Kingji i uroi kolonel Kablay-it suksese të mëtejshme në karrierën ushtarake. Atashë ushtarak

turk Muhamet Kemali Kablay u nderua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me Certifikatë Mirënjohjeje në shenjë falënderimi për kontributin e tij.



turk Muhamet Kemali Kablay u nderua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me Certifikatë Mirënjohjeje në shenjë falënderimi për kontributin e tij.

Efektivat e Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë trajnohen për përdorimin e pajisjeve speciale në luftim

Në kuadër të modernizimit të Forcës Tokësore me mjete e pajisje dhe në vazhdim të bashkëpunimit me ushtrinë amerikane, efektivët e Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë (bkl) në FT, kryen trajnime për përdorimin e këtyre pajisjeve nën drejtimin e specialistëve amerikanë. Bkl dhe Dega e Zbulimit në këtë batalion, po kryejnë trajnimin e operatorëve për përdorimin e avionëve pa pilot (UAV). Ky trajnim kryhet nën drejtimin e specialistëve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, USA.

Trajnimi kryhet me qëllim rritjen e kapaciteteve operacionale të trupave të zbulimit dhe realizimin në kohë të informimit për situatën reale të zhvillimit të veprimeve në fushën e luftimit. Gjithashtu përdorimi i këtyre pajisjeve do të realizojë mundësinë e grumbullimit të informacionit të zbulimit në interes të vendimmarrjes ushtarake.

Gjithashtu grupi i specialistëve amerikanë (SFAB) po trajnojnë prej tre ditësh drejtuesit e mjeteve të blinduara HMMWV të Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë.

Trajnimi ka si qëllim drejtimin e mjeteve të blinduara në kushtet e pamjes së kufizuar dhe të errësirës pa përdorur sistemin ndriçimit të mjeteve. Përdorimi i këtyre pajisjeve do të rrisë aftësitë luftarake të trupave në fushëbetëje, në çdo kohë dhe në kushte të vështira të motit.



Përkujtohet 70 - vjetori i ditës së krijimit të MADM

Në mjediset e Qendrës së Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë dhe Lëndëve të Rrezikshme (MADM) në Forcën Tokësore u zhvillua ceremonia e 70 - vjetorit të shërbimit të MADM.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtori i Shtabit në SHPFA, kolonel Aleksandër Pando dhe drejtorë drejtorish në SHPFA. Gjithashtu ishin të ftuar dhe veteranët të Shërbimit Kimik të FA-së.

Ceremoninë e hapi komandanti i kësaj qendre, nënkolonel Lorenc Velu, i cili uroi pjesëmarrësit në këtë ditë të shënuar për MADM dhe falënderoi veteranët e këtij shërbimi për kontributin e tyre ndër vite.

Më tej e mori fjalën komandanti i FT-së, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Ai përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi lart veprën e kimistëve të FA-së në vite në mënyrë të veçantë punën e veteranëve të sotëm, atyre që ngritën dhe drejtuan këtë shërbim. Ai vuri theksin në punën e specialistëve të kimisë në menaxhimin e kimikateve dhe hot-spotëve, duke theksuar se ky shërbim aktualisht vepron sipas standardeve të NATO-s.

Më tej komandanti në fjalën e tij i kushtoi rëndësi konceptimit dhe modernizimit të këtij shërbimi për të qenë të aftë dhe të ndërveprueshëm me partnerët tanë. Ai u shpreh se: "Transformimi i FA-së ka përfshirë dhe shërbimin e MADM-së për të qenë e pakët në numër, por e konceptuar e tillë që të jetë e ndërveprueshme për t'iu përgjigjur situatave të ndryshme, si dhe për të mbështetur e operuar me aleatët e partnerët tanë në operacione ndërkombëtare.

Në vijim të rritjes profesionale, ju jeni dhe objektivi kapaciteti i NATO-s, FT, SHPFA dhe MM, duke patur mbështetjen e plotë nga aleatët dhe partnerët tanë dhe veçanërisht SHBA-së,



më qëllim rritjen e mëtejshme të kapaciteteve operacionale të MADM-së, duke zhvilluar projekte për modernizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore, pajisjeve dhe infrastrukturës."

Në vazhdim e mori fjalën dr. ing. kimist Shyqyri Kondi, veteran dhe një nga themeluesit e shërbimit kimik dhe komandanti i njësisë së parë të mbrojtjes kimike të ngritur në vitin 1953.

Ai falënderoi pjesëmarrësit, duke i uruar festën dhe përcjellë falënderimet e shumë kolegëve të tij kimistë, tanimë në pension, brezave të rinj të shërbimit të MADM-së.

Në vazhdim u shpërndanë medalje "Për shërbim të veçantë", efektivëve të MADM-së, akorduar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.

Liderët urojnë:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë sh.t. z. Bajram Begaj

“Në këtë ditëlindje të 111-të të tyre ne përulemi, nderojmë dhe jemi mirënjohës për shërbimin, kontributin dhe sakrificat e të gjithë efektivëve që kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura!”

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë Edi Rama

“Në 111-vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura Shqiptare, efektivët tanë janë mishërim i përkushtimit ndaj sigurisë, lirisë dhe interesave të kombit tonë.”



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi

“111 vite nga krijimi i Forcave të Armatosura! Mirënjohje të thellë për të gjithë efektivët dhe personelin e angazhuar, të cilët janë të dedikuar që Forcat e Armatosura të jenë simboli më i mirë i forcës dhe përkushtimit ndaj sigurisë, lirisë dhe të interesave të kombit tonë. Krenarë për kontributin e jashtëzakonshëm si aleat dhe partner në NATO, ku do të vazhdojmë të jemi një forcë e fortë në skenën ndërkombëtare.”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji

“Të nderuar oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe punonjës civilë të Forcave të Armatosura, kam nderin dhe kënaqësinë që t’ju përcjell urimet e mia të përzemërta me rastin e 4 Dhjetorit, Ditës së Krijimit të Forcave të Armatosura!

Më 4 dhjetorin e vitit 1912, plot 111 vite më parë, së bashku me shtetin e ri shqiptar, u krijuan edhe Forcat e Armatosura Shqiptare. Forcat e Armatosura gjatë rrugëtimit mbi njëshekullor, kanë luajtur një rol vital dhe të pazëvendësueshëm, si një institucion i vlerave më të larta dhe cilësive më të mira.

Shqipëria sot renditet në Aleancën më të madhe politike dhe ushtarake më të suksesshme të të gjitha kohërave, atë të Atlantikut të Veriut. Burrat dhe gratë nën uniformë janë nderi dhe krenaria e vendit, falë angazhimeve dhe kontributeve të rëndësishme në misionet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare, si garantë të paqes dhe të sigurisë.

Në këtë datë të shënuar shpreh mirënjohjen dhe respektin e veçantë ndaj të gjithë efektivëve që kanë shërbyer ndër vite në radhët e Forcave të Armatosura. Një urim të veçantë dëshiroj që të adresoj për të gjithë personelin ushtarak të angazhuar në shtabet e NATO-s dhe në misionet e ndryshme jashtë vendit në detin Egje, Bullgari, Letoni, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë, Sudanin e Jugut dhe Egjipt.

Forcat e Armatosura gëzojnë vlerësimin dhe respektin qytetar, falë angazhimeve, punës dhe sakrificës në përgjigje të situatave emergjente anembanë vendit. Ky përvjetor i gjen Forcat e Armatosura më të ndërveprueshme, të mirë pajisura dhe më të trajnuara, falë mbështetjes së gjithanshme në drejtim të modernizimit, trajtimit financiar dhe përkujdesjes sociale.

Shërbimi ndaj atdheut dhe Aleancës Euroatlantike do të jetë detyrimi ynë i përhershëm. Shpreh bindjen se do ta përmbushim me sukses misionin tonë kushtetues, duke punuar të gjithë së bashku me përkushtim, ndershmëri dhe profesionalizëm, deri në sakrificën më sublime!”

Inaugurohet Muzeu i ri i Forcave të Armatosura

Muzeu i Forcave të Armatosura, tashmë me godinë të re, e cila ndodhet në një nga zonat më piktoreske pranë Tiranës, në Bërzhitë, do të sjellë për të apasionuarit e artit dhe historisë ushtarake, vlerat e papërsëritshme të kontributit të burrave dhe grave në uniformën ushtarake si dhe armatimet luftarake të ardhura në shekuj si një trashëgimi e vyer e kombit shqiptar.

Në ceremoninë e inaugurimit të hapësirave të reja morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Iglj Hasani, ministrja për Rininë Bora Muzhaqi, ish-ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, deputetë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu si dhe komandantë të forcave të ndryshme.

Të pranishmit u njohën me hapësirat e reja të muzeut, i cili është i ndarë në 5 pavijone, në të cilat janë të ekspozuara objekte, informacione për historinë ushtarake, ilustrime me harta dhe foto, që nga ilirët e deri në ditët e sotme.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u foli të pranishmëve për funksionet e këtij muzeu, jo vetëm si qendër për vizitorët e shumtë, nxënës të shkollave, apo edhe turistët e huaj, por edhe si qendër aktiviteteve të ndryshme.

Në pavijonin e parë janë të ekspozuara rreth 110 objekte që prezantojnë momentet më të rëndësishme të historisë së Shqipërisë, si Epoka e Skënderbeut, Pashallëqet, Lidhja e Prizrenit, Pavarësia dhe Lufta e Dytë Botërore.



Garda Kombëtare e New Jersey-t, vizitë në QAPN

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Gardës Kombëtare të New Jersey-t dhe Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve, AFA, një ekip ushtarakësh oficerë dhe nënoficerë vizituan QAPN-në. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte krijimi i asistencës dhe mbështetjes së trupës së nënoficerëve të QAPN-së, si dhe planifikimi në vijim i aktiviteteve për vitin 2024-2025.



Monografia e gjeneralmajor Manushaqe Shehut: "Lidershipi dhe menaxhimi i sigurisë"

Në 111-vjetorin e Forcave të Armatosura, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu solli për lexuesin ushtarak, por jo vetëm, studimin e saj disavjeçar mbi lidershipin në mjedisin e sigurisë.

Monografia "Lidershipi dhe menaxhimi i sigurisë", u prezantua në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë, ku të pranishëm ishin ushtarakë, gjeneralë, komandantë forcash, akademikë si dhe ish-presidenti i Republikës z. Alfred Moisiu, i cili shprehu vlerësimet e tij për figurën e gjeneralmajor Shehut, punën e saj si drejtuese dhe përfaqësuese dinjitoze e grave në uniformë.

Ish-president Moisiu vlerësoi monografinë e gjeneralmajor Shehut, jo vetëm si një kontribut, por si një rast të veçantë të trajtimit të problemit të drejtimit ushtarak. Kjo sipas tij për faktin se gjeneralmajor Shehu, ka përshkruar me hollësi, jo si diçka të pamundur, lidershipin në menaxhimin e sigurisë në kodin etik dhe të rëndësisë së tij. Kjo monografi pasqyron misionin dhe rolin e Forcave të Armatosura Shqiptare përgjatë historisë 111-vjeçare të shtetit, për të kontribuar në sigurinë kombëtare të vendit. Në të reflektohet më së miri përvoja e saj në krye të korpusit të oficerëve të lartë si numri dy i Forcave tona të Armatosura.

"Të drejtosh do të thotë të kesh vizion të qartë për sa i përket synimeve dhe arritjeve dhe se udhëheqja është para së gjithash një përkushtim sublim për t'i shërbyer me përgjegjësi interesave kombëtare", - do të shprehej në monografinë e saj dr. Shehu.

Më së miri, këto koncepte i trajtuan në kumtesat e tyre prof. asoc. dr. Bernard Zotaj dhe prof. asoc. dr. Zaho Golemi.

Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj: 'Libri "Lidershipi në mjedisin e sigurisë", monografi e autores gjeneralmajor dr. Manushaqe Shehu, është një punim i plotë dhe i arrirë. Ai trajton gjerësisht lidershipin dhe ndikimi e tij në menaxhimin e mjedisit të sigurisë dhe është një ndihmesë e vyer për misionin e FA-së në një mjedis sigurie të ndryshuar. Në libër autorja ka shtrirë dhe analizuar një informacion të gjerë, duke arritur në përfundime që kanë vlera njohëse. Në saje të këtij misioni ka ndërtuar me kujdes dhe strukturën e librit.

Libri me krerë të veçantë, i ka lejuar autores, vëzhgimin, studimin dhe kërkimin, duke vendosur në qendër lidershipin e institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes që me krijimin e shtetit shqiptar, në periudhat e ndryshme të historisë 111-vjeçare të Shqipërisë, por dhe të Ballkanit e më gjerë, përmes përfaqësues së karakteristikave të përbashkëta dhe dukurive të veçanta e dalluese. Me anë të këtij libri autorja ka synuar të dëshmojë se lidershipi dhe ndikimi i tij në mjedisin e sigurisë luan një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe afrimin e nismave rajonale të përbashkëta, për të përballuar sfidat e mëdha që qëndrojnë përpara shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Autorja analizon dhe trajton me kompetencë çështjet e lidershipit strategjik që është preokupacion i qëndrueshëm dhe i përhershëm i FA-së, pasi nga përvoja e saj, duke qenë në krye të korpusit të oficerëve të lartë, punon dhe lufton për të përmbushur sa më mirë misionin dhe rolin e tyre, për të kontribuar në sigurinë kombëtare të vendit. Në libër shpjegohen strategjinë e lidershipit strategjik



nga pikëpamja e rolit të FA-së në sigurinë kombëtare. Gjithashtu, janë evidentuar gjetje të mira dhe interesante, jo vetëm nga çështjet, por ç' ka është më e rëndësishme në përmbajtje, duke përfshirë përfundime dhe pasqyrën e burimeve bibliografike. Më konkretisht: në kreun e parë 'Lidershipi dhe menaxhimi i sigurisë', me shumë kujdes dhe vëmendje ka trajtuar dhe përshkruar në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, analizën e veçorive të lidershipit dhe të menaxhimit të sigurisë. Përparësi iu ka dhënë problemeve të tilla si, të koncepteve të përgjithshëm për figurën e liderit, diplomacia dhe ndikimi mbi sigurinë, me përparësi rasti i Shqipërisë, si dhe komunikimi, traditat, ligjet dhe lidershipi strategjik. Në kreun e dytë autorja me një gjuhë dhe stil të qartë, dhe me profesionalizëm të lartë, trajton "kodin etik dhe rëndësinë e tij", ku rëndësi iu ka dhënë problemeve të ç' mitizimit dhe respektimit të mendimit, etikës së komunikimit, drejtuesit të suksesshëm, motivimit të lidershipit në veprimtarinë drejtuese e menaxhuese, si dhe disa nga teoritë themelore në zhvillimin e motivimit.

Kreu i tretë përshkruan, "konsensusin, kryefjala e liderit në pakt me sigurinë e Shqipërisë".

Libri përbën një trajtesë të plotë të lidershipit në mjedisin e ri të sigurisë.

Autorja trajton me kompetencë filozofinë e rolit të lidershipit në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, ndikimin e tyre për mbështetjen dhe zhvillimin e proceseve demokratike e integruese etj. Monografia plotëson edhe boshllëkun që ekziston në trajtesën e lidershipit në fushën e sigurisë, si në rrafshin teknik, ashtu dhe në atë praktik të njohjes e të zbatimit të tij. Autorja, falë përvojës së saj të

punës në FA, si dhe angazhimit në institucione elitare brenda vendit, por dhe në veprimtari ndërkombëtare, me karrierën e saj ushtarake, me shkrime, studime e kualifikime cilësore të kryera, shfrytëzim të një literature bashkëkohore etj.

Në kumtesën e tij prof. asoc. dr. Zaho Golemi e vlerëson librin "Lidershipi në mjedisin e sigurisë" si një trajtesë të plotë të lidershipit në mjedisin e ri të sigurisë.

Strategjia dhe Lidershipi në mjedisin e sigurisë përballë trinitit "Detyra-Nderi-Atdheu". Nëse çdo gjeneral do të kishte shkruar të paktën një libër me përvojat e tij apo të zhvillimeve për kohën, periudhën, epokën që shërbeu në strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë, do të kishim sot qindra libra, ndoshta dhe mijëra, një përvojë që jo gjithmonë transmetohet.

Prandaj vlera e librit më të ri "Lidershipi në mjedisin e sigurisë", i gjeneralmajor Manushaqe Shehut, është si libri më i ri i mirë menduar e gjykuar, në dispozicion të studiuesve të fushës së Mbrojtjes dhe Sigurisë, është një vlerë e shtuar dhe një prurje e re për Akademitë ushtarake dhe Sigurisë së vendit, për mjedisin intelektual dhe akademik, por edhe për lexuesin e gjerë. Është fakt se studimet në fushën e lidershipit

të mjedisit të sigurisë në bibliotekat tona të shkollave e Akademive Ushtarake, por dhe në Bibliotekën kombëtare, janë të rralla, ndërkohë që literatura perëndimore dhe më gjerë është e tej mbushur me prurje interesante në këtë fushë dhe që janë përdorur gjerësisht në librin "Lidershipi në mjedisin e sigurisë" të gjeneralmajor Manushaqe Shehut. Libri është konceptuar në pesë pjesë: "Lidershipi dhe menaxhimi i sigurisë", "Kodi etik dhe rëndësia e tij", "Konsensusi, kryefjala e liderit në pakt me sigurinë", "Roli udhëheqës politik në fushën e sigurisë" dhe "Ballkani, ndryshimet euroatlantike dhe roli i Shqipërisë".

Me 252 faqe, ka shfrytëzuar një literaturë në gjuhë të huaj prej 55 librash, 34 libra në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga literatura më e përzgjedhur botërore në fushën e lidershipit, si dhe mjaft punime të profesorëve të Akademisë së Forcave të Armatosura, si "Moraliteti dhe etika e ushtarakut në Forcat e Armatosura", "Etika, Komunikimi dhe Lidershipi"; janë shfrytëzuar disa nga publikimet më të spikatura të fushës së lidershipit dhe mjedisit të sigurisë, gazeta e revista nga personalitetet e botës dhe ato shqiptare, sikurse është ajo në gazetën "Kombi", Alfred Moisiu, "Politika e mbrojtjes t'u shërbejë interesave kombëtare", publikime të tjera si: "Shqipëria, koncepti i ri i sigurisë", publikime të revistës "Mbrojtja", gazetës "Ushtria", Revista ushtarake, "Studime të Historisë Ushtarake", burime të spikatura nga interneti etj.

Libri në mënyrë të përzgjedhur ka synuar dhe ia ka arritur të ketë një aparat të pasur shkencor edhe përmes 188 referencash të fushës së lidershipit. Libri "Lidershipi në mjedisin e sigurisë", është një prurje e re në kohën dhe vendin e duhur, një libër që nuk i kalon kurrë koha, sepse liderët në të gjitha epokat e zhvillimit kanë nevojë për përvojat e brezave dhe zhvillimeve. Dhe ja, ky është një prej tyre, i pritshëm dhe i duhur, jo për stoli bibliotekash por si një vlerë për të gjitha nivelet e lidershipit ushtarak dhe jo vetëm. Nuk ka lider që nuk ka shfrytëzuar dhe marrë përvojat më të mira, ndërkohë që një postulat më shumë se dy shekullor është ajo çfarë thoshte Napoleon Bonaparti se: "Nëse dëshiron që gjërat të bëhen mirë, bëji vetë". Kjo është praktika më e mirë e mësimit të drejtimit me krijimtari'.

Ndërsa prof. Zaho Golemi e vlerësoi librin si vlerë e kulturë për sot dhe për të ardhmen, referencë e përzgjedhur për drejtuesit në të gjitha nivelet e drejtimit ushtarak, një kontribut i shkruar dhe dokumentuar pas një përvoje dhe eksperience të gjatë pune në strukturat e Mbrojtjes dhe Sigurisë shqiptare.

"Libri sjell reflektim mbi përvojat e drejtimit të lidershipit, menaxhimin e çështjeve esenciale të strategjisë në mjedisin aktual dhe në fokusin e së ardhmes në çështjet e sigurisë, në konceptimin e figurës e lidershipit në fushën e sigurisë e mbrojtjes, të parë në këndvështrimin e gjerë dhe të ndërthurur me institucionet ligj zbatuese të sigurisë në Shqipëri", - tha ndër të tjera prof. asoc. dr. Zaho Golemi.



“Është e vështirë të jesh femër, duhet të mendosh si një burrë, të sillesh si zonjë, të dukesh si vajzë dhe të punosh pafund, Unë ia dola!”

Ambientet e punës të Qendrës së Personel Rekrutimit në garnizonin “Skënderbej”, ndodhen në krah të institucionit ku është vendndodhja e redaksisë të Shtypit Ushtarak. Dhe të duhet të bësh vetëm pak hapa për t’u njohur me punën e madhe që bëhet tek kjo qendër me një mision mjaft domethënës siç është ai i menaxhimit të ciklit jetësor të burimeve njerëzore të FA-së.

Por objekti i këtij shkrimi sot është ndryshe nga herët e tjera, kur ne kemi sjellë në faqet e shtypit tonë Qendrën e Personel Rekrutimit, se si ajo zhvillon procesin e rekrutimit me qëllim që FA-ja të ketë një brez të ri për të kryer të gjitha detyrat në përmbushje të misionit kushtetues, apo risinë nëpërmjet programit të automatizimit të të dhënave të personelit aktiv, administrimin e tyre në sistem me transparencë, përkushtim dhe profesionalizëm, që është baza e ecurisë në karrierë të personelit të FA-së. Apo më tej, administrimin e të gjitha dosjeve të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe i të dhënave të kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Apo bashkëpunimin në mënyrë të vazhdueshme me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Qarqe, Postën Shqiptare në të gjithë vendin, pushtetin qendror dhe vendor si dhe të gjitha institucionet e tjera brenda dhe jashtë FA-së, etj.

E nëse do të vazhdonim të rendisim aktivitetin ditor të QPR-së, pa dyshim do të ishte një listë e gjatë e aktivitetit të këtij institucioni, dhe për më tepër kur numri i personelit të qendrës është dyfishuar dhe ajo tani shtrihet në gjithë hartën e Shqipërisë. Pasi në të 12 qarqet e vendit janë ngritur seksionet e rekrutim-mobilizimit që përmirësojnë procesin e rekrutimit të brezit të ri si kontingjent i FA-së, dhe si themeli dhe baza e krijimit dhe zhvillimit të komponentit të rezervës, e cila tashmë është një sfidë jo vetëm për QPR, por për vetë FA-në.

Dhe brenda këtij institucioni mes dhjetëra burrash dhe grash në uniformën ushtarake ose jo, prej vitesh e papërtuar në misionin e saj është dhe majore Semiko Kryemadhi.

Majore Semiko Kryemadhi kryen detyrën e shëfës së Seksionit të Sekretarisë në QPR. Majore Semiko përgjigjet për administrimin, qarkullimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve të QPR-së dhe institucionet e vartësisë, përpunimin tekniko-shkencor, shfrytëzimin dhe ruajtjen e fondit arkivor të QPR-së. Por majore Semiko është ushtarakja model për korrektësinë dhe figurën e femrës në uniformë dhe jo vetëm në detyrën aktuale në QPR, por në të gjitha detyrat e ngarkuara gjatë karrierës së saj si oficerë aktive në FA. “Majore Semi është ‘kyç’, na thonë kolegët e saj, kur na përshkruajnë performancën e majores, lidhur me zbatimin e detyrës që ajo ka, “është ushtarakja që çdo staf dhe titullar do të donte të punonte me të”, na thonë teksa na flasin për seriozitetin, rëndësinë e duhur dhe respektin me të cilin ajo trajton dhe menaxhon kohën ditore të punës të saj në QPR.

Detyrat kryesore të shëfës Semit, siç e thërrasin shkurtimisht në QPR janë pranimi/marrja e dokumentacionit dhe evidentimi i tij, shpërndaja dhe dërgimi i korrespondencës zyrtare, kontrolli dhe zbatimimi i kërkesave që duhet të përmbushë dokumenti. Ajo hap dosjet sipas pasqyrës emërtuese dhe i sistemon në to në mënyrë të vazhdueshme dokumentet që krijohen e vijnë gjatë vitit, por plotëson edhe kërkesat për shfrytëzim operativ nga sektorët, duke bërë evidentimin e tyre dhe respekton korrektësisht dispozitat në fuqi për ruajtjen e sekretit shtetëror. Gjithashtu shëfë Semi mirëmban e ruan vulën dhe dokumentet zyrtare, bën mbylljen dhe inventarizimin e dosjeve të çelura sipas pasqyrës emërtuese si dhe bën dorëzimin e tyre në arkiv. “Këto janë disa nga detyrat e mia të përditshme”, - thotë majorja.

QPR është një institucion që kryen numrin më të madh të procedurave administrative se çdo strukturë tjetër në FA, pasi i tillë është edhe objekti i punës dhe misioni i institucionit dhe këto procedura mund të arrijnë edhe në disa mijëra gjatë një dite pune. Prandaj një detyrë tjetër po kaq e rëndësishme e shëfës së Sekretarisë, majores Semiko, është të ndjekë me evidencë të rregullt dorëzimin e të gjithë praktikave dokumentare nga sektorët dhe në fund të çdo viti, në bazë të regjistrit të korrespondencës (mod.1), ajo verifikon tërësinë e dokumenteve të dorëzuara dhe bën shënimet përkatëse në të. Ajo organizon dhe drejton punën që brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës të përfundojë përpunimin tekniko-shkencor (arkivimin) e dokumenteve të klasifikuar dhe atyre të paklasifikuar sipas rregullave



për punën me dokumentet administrative. Përgatit listat e veçimit për dokumentet e klasifikuara që i ka kaluar afati i ruajtjes dhe ia paraqet komisionit të ekspertizës për miratim, por ajo organizon gjithashtu punën për dokumentacionin me rëndësi historike kombëtare (RHK) që të dorëzohen me procesverbal në Arkivin Qendror të FA-së, mbasi kanë plotësuar 10 vjet në arkivin e QPR-së.

Udhëtimi nga studente e Shkollës Ushtarake në oficerë aktive

Semiko Kryemadhi, oficerja nga Skrapari, e nisi rrugën e saj si ushtarakë aktive në detyrën e saj të parë si shëfë Shtabi në repartin e Këmbësorisë në Përmet, për të kaluar më tej në qytetin e Beratit ku ka qëndruar për disa vite, e për të vazhduar më tej në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura në Tiranë, ku është dhe aktualisht në QPR.

Semiko, ka lindur më 14 nëntor 1968, në Skrapar, në një familje të thjeshtë, por me tradita atdhedashurie të spikatura të një familjeje shqiptare.

E ndërsa na tregon për veten ajo thotë se në vendlindje mbaroi me rezultate shumë të mira shkollimin e saj tetëvjeçar po ashtu edhe gjimnazin. “Adoleshenca ime ka qenë e qetë, por kisha gjithmonë një dëshirë të madhe brenda vetes për të vazhduar shkollën e lartë”, - na thotë ajo. “Kisha disa dëshira, disa ëndrra si çdo fëmijë tjetër për profesionet e së ardhmes, por në momentin që mbarova gjimnazin dëshira ime tashmë kishte marrë formë. Dëshiroja të bëhesha oficerë dhe e doja fort këtë gjë”, - thotë majore Semi. “Ishte uniforma ushtarake e xhaxhait tim ajo që më kishte bërë për vete dhe që më vonë më dha profesionin tim kaq të dashur të cilin edhe në ditët e sotme s’do ta kisha ndërruar me asnjë tjetër”. Majore Semiko na thotë gjithashtu se ëndrrës të saj i dha krahë edhe prania e shumë ushtarakëve në Çorovodë, Poliçan, ku atë kohë ishte dislokuar një nga uzinat e njohura të prodhimit të armëve luftarake dhe ku ushtarakët së bashku edhe familjet e tyre në qytezën e vogël ishin shembulli më i bukur për banorët vendas.

“Nuk do ta harroj kurrë vjeshtën e vitit 1987, kur më njoftuan se më ishte miratuar kërkesa ime për të ndjekur studimet në shkollën e Lartë Ushtarake në Tiranë. Gëzimi ishte i papërshkrueshëm! Do të vishja uniformën e gjelbër ushtarake dhe ëndrra që kisha brenda vetes do të më bëhej realitet”, - na thotë ushtarakja e realizuar. Dhe na tregon për fillimin e jetës ushtarake, për shoqet e para të cilat vinin si ajo nga disa rrethe të vendit, për konviktin, për leksionet, seminarët, për oraret e stërvitjes, për

rreshtimin para epërëve, për terrenet e vështira, për marshimet ushtarake, për pajimet mbi shpinë, për të gjitha vështirësitë e para, por edhe ato të mëvonshmet. Për aksionet dhe aktivitetet kulturore e sportive që ishin në programin dhe traditën e kësaj shkolle të lartë ushtarake.

Por gjithçka nuk ishte siç e kishte ëndërruar vajza e re, por megjithatë ishte shumë e bukur thotë ajo. “Ishte një ndjenjë e bukur që unë dhe shoqet e mia e mbanim në zemër, nën hijeshinë e uniformave tona, edhe pse na privonte në disa drejtime, pasi ne të gjitha ishim me dëshirë tonë në atë shkollë të vështirë për vajzat. Dita jonë ishte e veçantë, ndryshe nga ajo e moshatareve tona që studionin në një fakultet civil”.

Oficerë Semiko studimet i ka kryer në Fakultetin Gjitharmësh për Këmbësori, një nga specialitetet e

vështira për vajzat ushtarake, por që ishte në të njëjtën kohë edhe fakulteti me numrin më të madh të studenteve që do të përgatiteshin për oficerë. “Në fillim doja të vazhdoja logjistike ose financë, dy specialitete që ndoshta atëherë më dukeshin si më të përshtatshme për një vajzë, por e gjeta veten shpejt në specialitetin tim dhe nuk e pata të vështirë më tej”, - thotë ajo. Të gjitha vajzat e atij kursi kanë mbaruar të njëjtin specialitet, këmbësori. Kështu ishte përcaktuar për të gjithë kursin, ishte “planifikim nga lart”.

Por për vajzën e re të ardhur nga Skrapari, vitet studentore i sjellin edhe kujtime të tjera të cilat i shënuan jetën, pasi që në vitet e para të shkollës ajo u njoh me shokun e saj të jetës, gjithashtu edhe ai ushtarak dhe të dy së bashku kanë krijuar familjen e tyre të mrekullueshme me dy fëmijët, dy vajzat si drita, të shkolluara e që kanë nisur rrugëtimin e tyre në jetë dhe që i kanë bërë krenarë dhe i kanë lumturuar prindërit me arritjet e tyre. “Është bukur kur njeriu që ke në krah është i profesionit tënd, - thotë Semi, - sepse vështirësia e punës së një ushtarakeje dihet dhe kur ke njeriun që e njeh këtë profesion disa vështirësi kapërcehen më lehtë dhe mirëkuptimi brenda familjes është më i madh”.

Semiko, pasi përfundoi studimet ushtarake, në vitin 1991, u diplomua dhe mori titullin “oficer aktiv” dhe detyra e saj e parë ishte shëfë Shtabi në repartin e Këmbësorisë në Përmet. Ishte detyra që do ta përballte me vështirësitë dhe përgjegjësitë e reja të punës, por që asnjëherë nuk janë vështirësi që nuk kapërcehen nga ushtarakët brenda një stafi, pasi përveç përgatitjes së tyre ata kanë gjetur atje kolegë, eprorë dhe vartës, mbështetës dhe bashkëpunues. Pas punës në një staf të tillë ajo u emërua për të kaluar më tej në qytetin e Beratit, ku ka qëndruar për disa vite në strukturat e FA-së në atë qytet, e për të vazhduar më tej në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura në Tiranë, ku dhe është aktualisht, në QPR.

Në vitet 1991-2002, oficerë Semi ka punuar në brigadën e Këmbësorisë në Berat, në sektorin Sekretari dhe Programim. Në strukturat e ndryshme në FA të dislokuar në Tiranë ajo ka kryer disa detyra të tjera si shëfë logjistike, shëfë Sekretarie dhe shëfë Sekretarie e Shifrës, shëfë e BCU-së, etj., në Brigadën e Logjistikës në Tiranë. Kurse në vitet 2013-2014, në Akademinë Ushtarake të FA-së në detyrën shëfë në Seksionin Logjistik dhe që nga viti 2014 e në vazhdim ajo punon në Qendrën e Personel Rekrutimit, në fillim në seksionin Mbështetës e më tej në pozicionin aktual si shëfë Sekretarie.

Majore Semiko Kryemadhi tashmë me eksperiencën e saj të grumbulluar në kaq vite punon me profesionalizëm, por gjithashtu vazhdon të jetë kërkuese në respekt të punës, të njohurive për procedurat e punës, organizimit dhe administrimit të dokumentacionit. Eksperiencë që e bën të jetë korrekte në të gjitha raportet me eprorët, kolegët dhe vartëset.

Shëfë Semi është një natyrë tepër e rezervuar, një zonjë në uniformë, e cila me një zë të qetë të flet modestisht për veten, për arritjet e saj, për angazhimet, për marrjen pjesë në grupe pune, seminarë, mbledhje mësimore, vetë, si dhe me personelin që është i angazhuar në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave që i janë ngarkuar, për përparimin në gradë etj. Ajo ka kaluar dhe është kualifikuar në testet e gjuhëve të huaja si në anglisht STANAG dhe ALCPT dhe ka vlerësimin “shkëlqyeshëm”, në dosjen e saj personale nga eprorët. Gjithashtu majore Semiko Kryemadhi është dekoruar dy herë me medalje gjatë performancës së saj në punë, për realizimin e detyrave të ngarkuara dhe për përkushtimin dhe angazhimin maksimal, medalje si ajo e SHP-PSHV në vitin 2022 dhe Medaljen e SH-MK 15 në vitin 2010.



Baza Ajrore Farkë, modernizimi i një strukture, simbol bashkëpunimi

Baza Ajrore Farkë shënoi, më 6 dhjetor 2023, vitin e 56-të të krijimit të saj. Tashmë, ajo prej mbi gjysmë shekulli, me pilotët, teknikët dhe helikopterët e saj, u shërben qytetarëve dhe kombit shqiptar, madje edhe shpesh herë kur rastet kanë qenë nga më kritikët, prej kushteve të motit, emergjencave civile, ata kanë qenë pararojë në shërbim të jetës.

56-vjetori i krijimit e gjen Bazën Ajrore Farkë më të modernizuar në teknikë, pajisje dhe personel, me helikopterët bashkëkohorë, duke e bërë atë më operacionale edhe në misionet ndërkombëtare.

Baza Ajrore Farkë ka ecur në rrugëtimin e saj prej më se gjysmë shekulli me përpjekje, kurajë, mundin e djersën e derdhur ndër vite nga breza të tërë pilotësh, teknikësh, specialistësh, të cilët kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre në përmbushje të misionit dhe detyrave në shërbim të qytetarëve dhe vendit. Ky kontribut i dhënë ndër vite prej tyre është transmetuar sot edhe tek brezat e rinj, që evidentohet me pjesëmarrjen e tyre në Emergjencat Civile në ndihmë të komunitetit, stërvitjet e përbashkëta brenda dhe jashtë vendit.

Që nga krijimi e në vazhdim kjo bazë ka dhënë gjithashtu një kontribut të shquar në realizimin e misioneve të ndryshme ushtarake dhe civile, ka zhvilluar stërvitje të përbashkëta me ushtritë e ndryshme të rajonit dhe ka ndihmuar komunitetin në zona malore të zëna nga dëborat, në operacionet për tërmetet, si dhe në krizën e kosovarëve në vitin 1999. Reformimi dhe modernizimi i Forcës Ajrore, dhe Bazës Ajrore Farkë me mjete dhe teknologji perëndimore të gjeneratave të fundit, është një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Baza Ajrore, ashtu sikurse e gjithë Forca Ajrore, ka në natyrën e shërbimit të saj nevojën dhe sfidën e vazhdueshme për t'u zhvilluar dhe modernizuar, por edhe për t'u transformuar në përgjigje të kërkesave të reja dhe standardeve bashkëkohore.

Si filloi historia 56-vjeçare e Bazës Ajrore Farkë

Në korrik 1956, pilotë dhe teknikë u dërguan në ish-Bashkimin Sovjetik për t'u trajnuar në përdorimin e helikopterëve. Në qershor 1957 u krijua Njësia e Transportit Ushtarak nr. 5818 dhe struktura e saj organizative përfshinte një MI-4, tre MI-1, disa avionë JAK-11, JAK-18 dhe PO-2. Komandant reparti në atë kohë u emërua Peço Polena, komandant i treshes së parë të MI-4 u emërua Petrit Malindi, Mersin Minxha u emërua komandant i treshes së dytë të MI-1 dhe Refit Jazo komandant i avionëve JAK-18. Këto pra ishin emërimet e para që hynë në histori.

Më 4 shtator 1957, mijëra njerëz në Tiranë panë për herë të parë në vendin tonë fluturimin me një helikopter në qiell. Helikopteri i pilotuar nga Peço Polena ka fluturuar mbi linjën Tiranë-Shkodër-Tiranë. Në qershor 1958, një nga helikopterët MI-1 u përplas dhe ai doli jashtë përdorimit. Fluturimet me helikopterë MI-4 vazhduan



duke përmbushur detyra speciale, veçanërisht në situatat dimërore të viteve 1958, '59, '60, në kushte shumë të vështira atmosferike.

Në vitin 1967, rreth 30 helikopterë të rinj MI-4 të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës u përfshinë në këtë njësi. Kjo njësi u emërua "Regjimenti i Helikopterëve", më 6 dhjetor 1967, dhe komandant i saj u emërua Lulo Musaj. Regjimenti përfshinte tre skuadrilje helikopterësh MI-4, një makineri për riparimin e helikopterëve, pistën për helikopterët që lejon ngritjen dhe uljen e njëkohshme të disa helikopterëve, kazeramat dhe kushte normale për personelin, rojet dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme për

përmbushjen e detyrave të tyre.

Baza Ajrore Farkë ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e stërvitjeve të ndryshme ushtarake të asaj kohe, por edhe në ndihmë të popullatës në emergjenca civile, veçanërisht në rastet e përmbajtjeve, zonave malore të bllokuara nga bora, tërmetet apo edhe në kohë krize.

Kjo bazë ka marrë pjesë edhe në disa stërvitje, si në stërvitje të Forcave Ajrore, edhe në stërvitje të përbashkëta me forca të reparteve të tjera të FA-së, duke treguar cilësi dhe nivel të lartë stërvitjeje fluturimi.

Për të kryer misionin e saj, personeli i kësaj baze trajnohet intensivisht për të mbajtur në gatishmëri të vazhdueshme teknikën ajrore, për kryerjen e detyrave si transportimi i trupave, operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), shpërndarja e ndihmave ushqimore, apo transportimi i pacientëve në emergjencave civile.

Vitet e fundit infrastruktura bazë u përmirësua ndjeshëm kryesisht falë ndihmës së dhënë nga ushtria italiane. Heliporti i ri është ndërtuar me të gjitha pajisjet e tij përkatëse për ulje dhe ngritje ditën dhe natën. U rikonstruktuan kazeramat, si dhe makineri për mirëmbajtjen e helikopterëve dhe kulla e drejtimit dhe fluturimit është e pajisur me mjete moderne.

Personeli i Bazës Ajrore të Farkës është kualifikuar për të përmbushur standardet dhe misionin e saj. Kjo bazë është simbol i bashkëpunimit me aleatët tanë në stërvitjet e përbashkëta, ku pjesëmarrësit kanë treguar dinjitet dhe profesionalizëm duke bashkërenduar veprimet për realizimin e misionit.

Çdo vit kryen mbi 500 fluturime në operacione humanitare për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për transportimin e të sëmurëve, kundër zjarreve, transportin e ndihmave humanitare, në mbështetje të komunitetit gjatë përmbajtjeve etj. Treguesi real dhe i prekshëm i mbarë Shqipërisë ishte kontributi i dhënë viteve të fundit gjatë përmbajtjeve në Shkodër, ku pavarësisht kushteve të papërshtatshme atmosferike, pilotët ndihmuar njerëzit. Pilotët e bazës ajrore janë trajnuar për të qenë në gjendje të kryejnë operacione ajrore në kushte të ndryshme moti dhe të ndërveprojnë me ushtritë e tjera aleate të NATO-s.

Pjesa më e madhe e personelit teknik dhe pilot është kualifikuar





në shkolla dhe njësi perëndimore si në Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Emrat që drejtuan Bazën e Farkës në vite dhe bënë historinë janë: Lulo Musai, Refat Kasimati, Hetem Mehmeti, Sinan Çela, Enver Taho, Beqir Barxha, Raqi Qarri, Syrja Gjoka dhe Frederik Beltoja etj.

Pilotët e Bazës Ajrore Farkë, heronjtë e ditëve tona

Baza Ajrore Farkë, është strukturë në përbërje të Forcës Ajrore që me kapacitetet e veta kryen mbështetjen me transport të kufizuar të trupave dhe materialeve, mbështetje teknike dhe mirëmbajtje për mjetet ajrore dhe evakuim shëndetësor në operacione luftarake dhe jo luftarake, operacione humanitare dhe të shërbimit SAR si dhe detyra të tjera në interes të operacionit.

Baza Ajrore Farkë ka për detyrë që në bashkëveprim me strukturat e Forcës Ajrore dhe të forcave të tjera të FA-së të sigurojë mbështetjen ajrore në operacionet e përbashkëta dhe në kuadër të realizimit të misionit kryen detyra kryesore si të sigurojë gatishmërinë luftarake të mjeteve fluturuese që ka në përdorim në përputhje me nivelet operacionale të përcaktuara, të realizojë përmbushjen e detyrave luftarake dhe atyre stërvitore në përputhje me standardet e ICAO, Eurokontroll dhe NATO, të realizojë transport trupash, materialesh dhe VIP në operacione luftarake, të mbështesë dhe kryejë operacione humanitare në ndihmë të popullsisë (emergjencat civile dhe fatkeqësitë natyrore). Baza Ajrore Farkë kryen detyra të zbulimit dhe rikonicionit me interes kombëtar dhe në kuadër të NATO-s, kryen monitorim sipas situatave të kufirit detar dhe tokësor në interes të detyrave speciale si dhe në interes të vendimmarrjeve të shpejta, zhvillon më vete ose në bashkëpunim me të tjerët operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), siguron përgatitjen dhe trajnimin e personelit sipas teknologjisë në përdorim dhe standardeve në interes të plotësimit të misioneve në lloje të ndryshme operacioni, siguron dhe realizon shërbimet e mirëmbajtjes në kohë dhe sipas kërkesave teknike të përcaktuara si për mjetet ajrore, ashtu edhe për mjetet tokësore që ka në përdorim. Ajo ka detyrë gjithashtu, të realizojë operacione MEDAVAC transport të sëmurësh, të marrë pjesë dhe mbështesë stërvitjet e ndryshme "Joint" me FA-të dhe institucionet e tjera të vendit.

Modernizimi i Bazës Ajrore Farkë, trajnimi dhe edukimi

Me investimet e reja, Baza Ajrore e Farkës ka tashmë një sistem të ri sigurie duke nisur që nga rrethimi i jashtëm, ndriçimi, e deri te sistemi i mbikëqyrjes 24 orë me kamera. Gjithashtu është rikonstruktuar objekti i klasave të pilotëve, si dhe mensa e tyre. Pjesë e këtij investimi janë edhe depot e reja të magazinimit të karburantit, të cilat janë të standardeve të NATO-s dhe më të sigurtat në Shqipëri. Pas këtyre investimeve, depot e reja në Bazën Ajrore të Farkës, garantojnë karburant për rreth 6 muaj, jo vetëm për helikopterët e Forcës Ajrore, por edhe për ata të Ministrisë së Brendshme dhe asaj të Shëndetësisë.

Nga ana tjetër, efektivët e Forcës Ajrore janë në vëmendje të veçantë të leadershipit politik dhe ushtarak të MM dhe SHP të FA-së, pasi puna dhe përkushtimi i tyre në situatat e ndryshme kanë qenë vendimtare dhe jetike. Pilotët dhe teknikët e kësaj baze, për angazhimet e tyre gjatë përbashkimit të situatës së krijuar nga reshjet e borës, emergjencat e zjarreve apo të situatave shëndetësore, kanë marrë vlerësime dhe mirënjohje maksimale për heroizmat e bëra, për devotshmërinë, guximin e treguar në shërbim të njerëzve dhe qytetarëve.

Baza Ajrore Farkë ndodhet në qendër të Republikës të Shqipërisë dhe mbulon të gjithë territorin e vendit në aspektin operacional. Duke qenë afër me Aeroportin Ndërkombëtar, ajo ka një pozicion perfekt për mbështetjen e Forcave Tokësore dhe Detare si dhe institucionet e tjera shtetërore.

Në shtator të vitit 1957, fluturimi i parë në qiellin shqiptar u krye me helikopterin MI-2. Ata u përdorën kryesisht për trajnim

dhe rikonicion ajror. Data 6 dhjetor, shënon edhe ditën e krijimit të Regjimentit të Helikopterëve. Regjimenti arriti të kishte një numër prej rreth 40 helikopterësh të tipit MI-4 të prodhimit Ruso-Kinez. Kurse versionet e Helikopterëve MI-4, ishin Transport Trupash dhe Materialesh, Aeroambulancë, Kërkim-Shpëtim, Transport PLSH, si dhe janë përdorur në Mbështetje të Autoriteteve Civile në Raste Fatkeqësish Natyrore.

Pas daljes nga fluturimi së helikopterit MI-4 në vitin 2002, në Bazën Ajrore Farkë filloi epoka e ndryshimit në teknologji, si dhe në konceptin e trajnimit dhe operimit.

Faza e I, quhet si faza e ndryshimit të teknologjisë, në 2002 me helikopter Trajnimi dhe Rikonicioni AB-206, në 2004 me Helikopter Transporti AB-205.

Faza e II, Zhvillimi me Helikopter Shumërolesh në 2007, Helikopter VIP, A-109 dhe po në 2007 me Helikopter Shumërolesh BO-105.

Faza e III, Modernizimi, në vitin 2012, Helikopter VIP Helikopter EC-145, në 2012 Helikopter SAR "Cougar" AS-532AL, në 2013, Helikopter CASEVAC "Cougar" AS-532AL, po në 2013, Helikopter TTH "Cougar" AS-532AL, në 2014, Helikopter TTH "Cougar" AS-532AL, dhe në 2015, Helikopter SAR EC-145. Në 2016, Grupi i Helikopterëve të Transportit Mjekësor, po në 2016, Sektori i Repartit Special RENE A.

Struktura Aktuale është Grupi i Helikopterëve të Transportit Mjekësor 11, versioni Aero-Ambulancë MEDEVAC. Gjithashtu përmendim edhe Grupin e Helikopterëve të Sektorit RENE A, që

mbështet operacionet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Grupi i mirëmbajtjes të helikopterëve realizon pjesërisht punë të nivelit të dytë.

Infrastruktura e Bazës Ajrore të Farkës përbëhet nga Qendra e Kontrollit të Trafikut Ajror, Hangarët e Helikopterëve, Qendra e Mirëmbajtjes së Helikopterëve. Plani i vendosjes së kuadrateve të uljes së helikopterëve si dhe rulimi/fluturimi për tek kuadrati i ngritjes "H". Plani i vendosjes së kuadrateve të uljes/ngritjes së helikopterëve si dhe rulimi/fluturimi për tek kuadrati i ngritjes "H".

Trajnim Bazë me helikopterin AB-206 dhe trajnim i avancuar me helikopterin dymotorësh BO-105, bazohet në eksperiencën e pilotëve. Përmendim implementimin e STANAG/AP dhe SOP të miratuar, Trajnimi Operacional i ekuipazheve mbështetur në ATP-49, "Përdorimi i Helikopterëve në Fushën e Operacionit" dhe ATP-10 "Operacionet SAR". Gjithashtu trajnimi në punë "On job training", për teknikët dhe specialistët e mirëmbajtjes, kurset Profesionale dhe ato të Karrierës gjithashtu.

Në bazë të ligjit, Forcat Ajrore janë përgjegjëse për kryerjen e misioneve SAR. Urdhri i misionit merret nëpërmjet QKR-së, Rinas. Misionet SAR/CASEVAC planëzohen nga Zyra Operacionale (OPS Office). Komandantët e Ekuipazheve janë përgjegjës për ekzekutimin e misionit. I rëndësishëm është gjithashtu bashkëpunimi me aviacionin civil. Marrëveshje teknike me "Albcontrol" për shfrytëzimin e infrastrukturës aeroportuale të Rinasit, LATI Fluturime Stërvitore Instrumentale, Fluturim Taktik Stërvitor, Trajnim duke shfrytëzuar infrastrukturën aeroportuale (Pistën, Taxi Ways...) Praktikë për terminologjinë e komunikimit në Anglisht, etj.

Objektivat e kapaciteteve dhe planifikimi i fluturimeve

Objektivat e kapaciteteve përmendim A1501 N "Kapacitetet e Gatishmërisë së Dislokueshme të Përcaktuara", (2018).A1105 N "Operacionet në kushtet e vështira të motit", (2017).A 5301 N "Mjetet e navigimit dhe radiot në mjetet ajrore", A 6206 N "Vetëmbrojtja e Mjeteve Ajrore", (2017).

Fluturime treneruese me pilotët e rinj, si dhe pilotët operacionale (jo më pak se 120 orë fluturimi për pilotët operacionale) Trajnimi i ekuipazheve SAR, Trajnimi i ekuipazheve IFR, Trajnimi i ekuipazheve NVG. Mundësimin e shërbimit 24 orë SAR. Stërvitje SAR dhe mirëmbajtjen e teknikës ajrore me kontraktor.

Planifikimi i fluturimeve ka për qëllim të sigurojë gatishmëri operacionale, të mbështesë Operacionet e Forcës Tokësore dhe Detare, të kryejë transport të trupave dhe materialeve ushtarake, të kryejë zbulim ajror, operacione CASEVAC dhe SAR. Të kryej transport ajror në rast të Emergjencave Civile dhe të fatkeqësive natyrore, të sigurojë dhe realizojë shërbimin e mirëmbajtjes, të stërvitë dhe trajnojnë personelin dhe pajisjet.



Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

NATO, pjesë e zgjidhjes globale për një sfidë globale

NATO pranon se përballet me shumë sfida mjedisore, veçanërisht për shkak të rreziqeve që vijnë nga ndryshimet klimatike, dhe ka vepruar në këto sfida për shumë vite. Ajo angazhohet në përgatitjen civile dhe reagimin emergjent ndaj fatkeqësive mjedisore si përmbytjet, zjarret në pyje dhe tërmetet. Aleanca fokusohet gjithashtu në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe reduktimin e gjurmës mjedisore të Forcave të Armatosura.

Koncepti Strategjik i NATO-s 2022, dokumenti kryesor i politikës së Aleancës, i cili udhëzon strategjinë e NATO-s gjatë viteve të ardhshme, thekson ndryshimin e klimës si një sfidë përcaktuese të kohës sonë, me një ndikim të thellë në sigurinë aleate. Ai thotë se NATO duhet të bëhet organizata kryesore ndërkombëtare kur bëhet fjalë për të kuptuar dhe përshtatur ndikimin e ndryshimeve klimatike në siguri. Ndërsa në Samitin e NATO-s 2023 në Vilnius, aleatët mirëpritën krijimin e një Qendre të Përsosmërisë së NATO-s për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë në Montreal, Kanada.

Duke marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike COP28, të organizuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe në Dubai, (dhjetor 2023), Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg nënvizoi se “ndryshimi i klimës ka rëndësi për sigurinë tonë, dhe për këtë arsye ka rëndësi për NATO-n”. Duke folur në takimin e liderëve të nivelit të lartë mbi sigurinë klimatike të organizuar nga Presidenca COP28 dhe Konferenca e Sigurisë në Mynih, z. Stoltenberg nënvizoi angazhimin e NATO-s për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të qenë pjesë e zgjidhjes globale për një sfidë globale.

Në një panel diskutimi, Sekretari i Përgjithshëm theksoi nevojën për të menaxhuar ndikimin e sigurisë së ndryshimeve klimatike, duke thënë se “ndryshimi i klimës krijon krizë dhe kriza minon mundësinë për të luftuar ndryshimet klimatike”. Duke pasur parasysh lidhjen e pazgjidhshme midis të dyjave, ai shpjegoi se ndryshimi i klimës është për rrjedhojë në thelb të misionit të NATO-s për të ndjekur paqen dhe sigurinë për Aleancën. Ai theksoi gjithashtu nevojën për të siguruar kalimin e energjisë nga lëndët djegëse fosile, drejt furnizimeve të sigurta dhe të rinovueshme të energjisë. Ai tha se: “Ne duhet të sigurojmë që kur të zbatojmë kalimin e energjisë nga lëndët djegëse fosile në burime më të besueshme dhe më pak ndotëse të energjisë, ne duhet të sigurohemi që të mos e bëjmë këtë në një mënyrë që minon sigurinë energjetike. Rusia përdori gazin si mjet për të na detyruar pas pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës. Ne nuk duhet të bëjmë të njëjtat gabime ndërsa zhvillojmë burime të reja të rinovueshme të energjisë”, - tha ai. “NATO prandaj po investon në programe për të zhvilluar teknologji të reja më miqësore ndaj mjedisit, që do të zvogëlojnë mbështetjen në lëndët djegëse fosile”, - shtoi ai.

NATO po i përshtat ushtritë e saj, si me ndryshimin e klimës ashtu edhe për të reduktuar emetimet. Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO ka prioritet adresimin e ndryshimeve klimatike në krye të axhendës së saj dhe ka rënë dakord për objektiva specifike për të reduktuar emetimet nga trupat dhe komandat e NATO-s deri në vitin 2030 dhe deri në vitin 2050, ne duhet të jemi si zero neto në Forcat e Armatosura”. Ai shtoi se NATO po shfrytëzon inovacionin teknologjik në mbrojtjen e gjelbër dhe po integron konsideratat e klimës në planet, stërvitjet dhe aftësitë e saj ushtarake.

Diskutimi i panelit përfshinte kryeministren e Estonisë Kaja Kallas, kryeministren islandeze Katrín Jakobsdóttir, të dërguarin e posaçëm presidencial të SHBA-së për Klimën John Kerry, drejtorin Ekzekutiv të Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara Inger Andersen, drejtorin Themelues të Qendrës së Universitetit Columbia për Politikë Globale të Energjisë, Jason Bordoff, dhe kryetarin e Konferencës së Sigurisë në Mynih, Christoph Heusgen.

Sekretari i Përgjithshëm gjatë vizitës së tij në Dubai u takua gjithashtu me liderë të tjerë ndërkombëtarë, përfshirë Presidentin e Irakut Abdul Latif Rashid dhe Presidentin e Mauritanisë Mohamed Ould Ghazouani, Presidentin polak Andrzej Duda dhe Presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan.

Ndryshimi i klimës dhe ngrohja globale, sfidat që kemi përballë

Në vitin 1969, NATO njohu për herë të parë sfidat mjedisore, duke krijuar Komitetin për Sfidat e Shoqërisë Moderne (CCMS), i cili menaxhoi studime dhe bursa që u fokusuan në çështje si ndotja e ajrit dhe zhurmës, kujdesi i avancuar shëndetësor dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme. Në vitin 2006, Komiteti i Shkencës i NATO-s u bashkua me CCMS për të formuar Programin Shkencë për Paqe dhe Siguri (SPS) për të zhvilluar iniciativa mbi sfidat e reja të sigurisë, duke përfshirë çështjet e sigurisë mjedisore si menaxhimi i ujit dhe parandalimi i katastrofave natyrore dhe siguria e energjisë. Organizata e Shkencës dhe Teknologjisë e NATO-s (STO) gjithashtu promovon dhe kryen kërkime shkencore në lidhje me çështjet mjedisore. Në vitin 2021, NATO miratoi një plan ambicioz veprimi për ndryshimet klimatike dhe sigurinë për të përfshirë konsideratat e ndryshimeve klimatike në axhendën politike dhe ushtarake të NATO-s.

Në fjalën e tij, që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mbajti në Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike (COP28) në Dubai, falënderoi mikpritësit vendas, organizatorët dhe Konferencën e Sigurisë së Mynihut për mbledhjen e këtij diskutimi shumë të rëndësishëm, “sepse është e rëndësishme, - tha ai, - që vërtet të përpiqemi të kuptojmë më mirë lidhjen midis ndryshimit të klimës dhe sigurisë dhe për të gjithë ne, është e qartë



se ndryshimi i klimës, ngrohja globale është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballemi”.

Ndoshta është më e qartë, shpjegoi ai pse NATO është këtu dhe pse Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s mori pjesë në këtë takim. Arsyeja pse jemi këtu pavarësisht faktit se jemi një aleancë ushtarake, që merremi me parandalimin dhe mbrojtjen dhe punojmë në çështjet e sigurisë, është sigurisht se ekziston një lidhje midis ndryshimit të klimës dhe sigurisë. Pra NATO është këtu sepse ndryshimi i klimës ka rëndësi për sigurinë tonë, dhe për këtë arsye ka rëndësi për NATO-n”, - tha Stoltenberg

Ndryshimi i klimës është një shumëfishues i krizës

Ndryshimet klimatike krijojnë kriza dhe krizat minojnë mundësinë për t'i luftuar ato, tha Shefi i NATO-s. “Para së gjithash, ne duhet të njohim plotësisht lidhjen midis ndryshimit të klimës dhe sigurisë që shkon në të dyja drejtimet. Ndryshimi i klimës është një shumëfishues i krizës. I detyron njerëzit të lëvizin. Flukset migratore janë në rritje për shkak të ndryshimeve klimatike tashmë. Por gjithashtu rrit konkurrencën për burime të pakta. Dhe në këtë mënyrë ndryshimi i klimës po nxit konfliktin. Dhe konflikti ka rëndësi për NATO-n dhe për sigurinë tonë”.

Por kjo shkon edhe anasjelltas, sepse luftërat dhe konfliktet e bëjnë më të vështirë luftimin e ndryshimeve klimatike. “Pjesërisht sepse minon besimin që na nevojitet midis kombeve për të ndërtuar arkitekturën e ndryshimeve klimatike, arkitekturën që na nevojitet për të luftuar ndryshimet klimatike. Dhe gjithashtu sepse burimet që duhet të ishin përdorur për të reduktuar emetimet, përdoren për të mbrojtur sigurinë tonë, në vend që të mbrojnë planetin, dhe se paqja, stabiliteti, siguria janë të lidhura me ndryshimet klimatike”, - tha ai.

“Ne duhet të ndajmë burime për të mbrojtur sigurinë tonë. Pra, paqja, stabiliteti, siguria janë jashtëzakonisht të rëndësishme për të na mundësuar të luftojmë ndryshimet klimatike. Nëse nuk keni sukses në ruajtjen e paqes, ne nuk do të kemi sukses në luftimin e ndryshimeve klimatike. Pra, kjo lidhje shkon në të dyja drejtimet. Ndryshimet klimatike krijojnë krizë dhe kriza minon mundësinë për të luftuar ndryshimet klimatike. Pra, kjo është në thelb ajo me të cilën po merret NATO”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

NATO, ‘fuqimisht pro’, në favor të tranzicionit energjetik

Si një çështje e dytë, ku u fokusua në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm në COP28, ishte se NATO është në favor të tranzicionit energjetik. “Në NATO, ne jemi fuqimisht në favor të tranzicionit energjetik. Por ne shohim gjithashtu sfidat që lidhen me atë që duhet të sigurojmë, që kur të zbatojmë kalimin e energjisë larg nga lëndët djegëse fosile drejt burimeve më të besueshme dhe më pak ndotëse të energjisë, duhet të sigurohemi që të mos e bëjmë këtë në një mënyrë të tillë, që të cenojë sigurinë energjetike”, - tha ai, duke sjellë më tej situatën me Rusinë. “Dy vjet më parë, ne kishim shumë liderë brenda Aleancës së NATO-s që thoshin se blerja e gazit nga Rusia ishte thjesht një çështje tregtare dhe se nuk ishte aspak një çështje politike, ne duhet t’ua lëmë kompanive të marrin vendime komerciale, jo politikanëve, që në një farë mënyre të përpiqen t’i kontrollojnë ato vendime tregtare. Por tani, - tha ai, - të gjithë e kuptojnë se, të qenit kaq i varur nga gazi rus ishte

një vendim politik. Bëhej fjalë për sigurinë tonë, sepse Rusia përdori gazin si mjet për të na detyruar pas pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës. Ne nuk duhet të bëjmë të njëjtat gabime ndërsa zhvillojmë burime të reja të rinovueshme të energjisë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg.

Ndërkohë që tashmë është e qartë gjithashtu dhe ekziston një sfidë që ka disa vende që kontrollojnë shumicën e teknologjisë, shumicën e lëndëve të para, mineralet e rralla të tokës, të cilat janë kaq të rëndësishme, për shembull, për panelet diellore ose bateritë. “Pra, ne nuk duhet të bëjmë të njëjtin gabim, duke qenë shumë të varur nga një ose dy furnizues jo të besueshëm të mallrave kritike, lëndëve të para kur bëjmë tranzicionin e energjisë”.

NATO përshtatet me ndryshimet klimatike dhe reduktimin e emetimeve

Mesazhi i tretë që dha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në fjalimin e tij ishte lidhja midis sigurisë dhe ndryshimeve klimatike, që NATO dhe aleatët e NATO-s duhet të përshtaten si me faktin që klima po ndryshon dhe gjithashtu, Aleanca të bëjë pjesën e saj në reduktimin e emetimeve.

“Moti më ekstrem do të ndikojë në mënyrën se si ne i zhvillojmë operacionet tona ushtarake, nga trajnimi deri te uniformat tona, tek fakti që bazat detare do të goditen nga nivelet e rritura të detit, kjo ka rëndësi për mënyrën se si ne i zhvillojmë operacionet tona ushtarake. Pra, duhet të përfshihet në misionet dhe operacionet tona dhe në planifikim, por ne gjithashtu duhet të sigurojmë që forcat tona të armatosura të bëjnë pjesën e tyre kur bëhet fjalë për reduktimin e emetimeve”, - tha Stoltenberg.

“Nuk ka asnjë mënyrë që të arrijmë në zero neto pa reduktuar gjithashtu emetimet nga sektori ushtarak. Dhe nëse shikojmë tanket e mëdha luftarake, luftanijet e mëdha dhe avionët luftarakë, ato janë shumë të avancuara dhe të shkëlqyera në shumë mënyra, por nuk janë shumë miqësore me mjedisin. Ato ndotin shumë, ndaj duhet të ulim emetimet”, - vërejtë Shefi i NATO-s.

“Prandaj, NATO po investon në programe për të zhvilluar teknologji të reja, më mjedisore për automjetet ushtarake. Për aeroplanët ne po përdorim disa biokarburante për disa avionë, po shqyrtojmë se si mund të përdorim panelet diellore për të ushqyer bazat tona, sepse kjo gjithashtu do të zvogëlojë elasticitetin e NATO-s ndaj karburanteve fosile. “Nëse do të duhej të zgjidhnim midis diçkaje që është e gjelbër ose efektive luftarake, ne duhet të zgjedhim zgjidhjen efektive luftarake. Pra, sfida është të sigurohemi që në të ardhmen, zgjidhjet efektive luftarake janë ato të gjelbra. Dhe unë jam mjaft optimist se do të jetë kështu, sepse po ndodh një revolucion në sektorin privat”, - tha Stoltenberg. Ai tha se në të ardhmen, motorët më efektivë, automjetet, avionët më efektivë do të jenë ata të gjelbër. “Për të siguruar që jemi përpara kurbës, ne gjithashtu duhet të sigurojmë që ushtria po lëviz drejt një zgjidhjeje teknologjike më të gjelbër dhe më të qëndrueshme”, - përfundoi Shefi i NATO-s, teksa parashtrroi tre arsyet pse ndryshimi klimatik ka rëndësi për NATO-n dhe pse NATO e ka vënë këtë në krye të axhendës dhe gjithashtu ka formatuar disa objektiva specifike, si të reduktojë emetimet e saj deri në vitin 2030. “Deri në vitin 2050, ne duhet të kemi zero neto edhe në Forcat e Armatosura”.



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

"Forca Rezervë, përtej paranojës së gjithë popullit ushtar"

Paraprakisht, si ekspert, dëshmitar apo kontribuues teknik në reformat e sistemit të sigurisë kombëtare si dhe në 30 vjet rrugëtim drejt dhe pas anëtarësimit në NATO (1993-2023) dëshiroj të shpreh konsiderata dhe rekomandime strategjike rreth përpjekjeve të RSH për ngritjen e Forcës Vullnetare Rezervë (FVR). Po ashtu, që në fillim të herës më duhet ta theksoj se është një ngjarje e vonuar, por njëkohësisht e domosdoshme për peshën në fushën e reformave Euro-Atlantike në FA si dhe modernizimin e kapaciteteve të mbrojtjes kombëtare.

Për realizimin e ngritjes së kësaj force, padyshim meriton të komplimentohet Ministri Peleshi, i cili ka sigurisht privilegjin dhe meritën që jo vetëm po e kurorëzon këtë përpjekje serioze, por edhe për arritjen e buxhetit të mbrojtjes 2 %; në dyfishimin e pagave të ushtarakëve; rikthimin e një profesionisti elitari krye të Forcave Detare; modernizimin e kapaciteteve operacionale, të planifikimit dhe cilësinë e bashkëpunimit me NATO-n.

Ky projekt është një qasje e përbotshme, që aplikohet nga 31 vendet e NATO-s si dhe nga 194 shtete të njohura nga OKB-ja, përfshi Islandën, e cila për shkak të një marrëveshje speciale me SHBA-të nuk ka forca aktive.

Ajo është edhe një qasje e përjetshme, pasi në të gjitha kohët dhe format e shtetit, asnjë vend, qoftë perandori, mbretëri, demokraci apo regjim diktatorial nuk mundet kurrësi të mbajë 100 % forca aktive për të gjithë skenarët e kërcënimeve apo ambicieve.

E thënë edhe më qartë, me zyrtarizimin e këtij projekti, RSH i bashkohet një përjasjeje moderne të konfirmuar edhe në doktrinën e NATO-s për planifikimin, ngritjen si dhe përdorimin e përkallëzuar të kapaciteteve dhe të fuqisë ushtarake.

Së dyti: cila është historia, çfarë përfaqëson, eksperiencat, strukturat dhe misioni i forcës vullnetare rezervë?

Përkufizimi në Wikipedia: "Një forcë vullnetare rezervë është një komponent ushtarak i shtetasve të një vendi që i bashkohet vullnetarisht forcave të armatosura, duke kombinuar karrierën civile edhe një detyrë ushtarake me kohë të pjesshme".

Historikisht, forca rezervë ka lindur pas disfatës së Prusianëve në betejën e Jena-Auerstedt-it, dhe me nënshkrimin e traktatit të Tilsit, më 9 korrik 1807, kur Napoleoni detyroi Prusinë të mos kishte një ushtri më të madhe se 42.000 vetë. Në këto kushte, reforma e quajtur Krumpersystem, e propozuar nga reformisti ushtarak prusian Gerhard von Scharnhorst, reflektoi me zgjuarsi, duke trajnuar mbi baza tremujore një numër rekrutësh që nuk e kalonin shifrën e sipër caktuar, por që në rast nevojë, përbënin një kontingjent ushtarak shumë herë më të madh. Ky koncept u përmirësua gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, si dhe më tej u ngrit në sistem të bazuar në specifikat e çdo vendi.

Pas Luftës së Ftohtë (1990), mjedisi strategjik i sigurisë, në rrafshin global, rajonal dhe kombëtar u imponua nga një ndryshim i ndjeshëm i natyrës së rreziqeve dhe konflikteve. Gjatë këtyre tre dekadave, përjashtoj rastin e sulmit neo-Nazist të Rusisë-Putiniste ndaj sovranitetit të Ukrainës: "kërcënimi kryesor për paqen dhe sigurinë nuk ka ardhur nga ndonjë konflikt i formës tradicionale ndërmjet shteteve, por nga rreziqe asimetrike, përfshi edhe krizat e brendshme të shteteve të dështuara, krimin e organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar!

Për rrjedhojë, ky ndryshim në natyrën e konflikteve, u shoqërua me shkurtime kritike në forcat e armatosura si dhe te buxhetet e mbrojtjes. Në shumicën e vendeve, përfshi RSH u kryen reforma radikale që synonin kalimin nga shërbimi mbarë popullor (popullit-ushtar) në shërbim të detyrueshëm aktiv si dhe forca të mbështetura nga një komponent rezervë vullnetare. Kjo tendencë u bë më e ndjeshme në vendet e vogla e me resurse të kufizuara.

Për më tepër, forca rezervë, janë bërë gjithmonë e më shumë pjesë e spektrit të operacioneve humanitare në mbështetje të paqes, përfshi ato brenda vendit në rastet e emergjencave civile, ndërsa pritet që në dekadën e tretë të shekullit të XXI, angazhimi i tyre të jetë akoma më i madh.

Forca rezervë është një forcë që përbëhet nga personel oficer, nënoficer dhe ushtarë, që bashkohen me një kontratë vullnetare në forcat e armatosura për të shërbyer vetëm në një kohë të përcaktuar (maksimumi 45 ditë), duke kryer detyra të përcaktuara në ligj.

Sigurisht forca rezervë vullnetare është më pak e kushtueshme se forca aktive, sepse ajo aktivizohet në kohë të pjesshme gjatë vitit. Ndërsa për specialitetet dhe detyra të caktuara, ajo është edhe më cilësore edhe se vetë forca aktive. Kjo ka bërë që vende të ndryshme, ta shikojnë forcën rezervë vullnetare si një opsion të leverdishëm të reformës në forcat e armatosura.

Në disa vende, edhe shërbimi ushtarak aktiv dhe edhe në rezervë, mbetet akoma i detyrueshëm, ndërsa në shumë vende të tjera, si shërbimi ushtarak në forcën aktive ashtu edhe shërbimi ushtarak në forcën rezervë është tërësisht vullnetar.

Në rastin e parë, shërbimi i detyrueshëm rezervë është karakteristikë e vendeve si Suedia, Finlanda, Izraeli, etj., të cilët kanë probleme të konflikteve historike dhe ushtarake me fqinjët.

Në rastin e dytë, shërbimi vullnetar rezervë është tipar i vendeve që relativisht janë çliruar nga problemet e konfrontimit tradicional. Ky shërbim aplikohet konkretisht me pjesëmarrje në operacion në shumicën e vendeve të NATO-s dhe BE-së si SHBA, Angli, Kanada, Francë, Gjermani, Belgjikë, Itali, Spanjë, Slloveni, Hungari, Kroaci, etj.

Si shembull, forcat Kanadeze në Afganistan, përfshinin mbi 30%



komponent rezervë, të dislokuar në Kandahar për të shërbyer atje 6 deri 9 muaj. Për më tepër, një pjesë e rezervistëve në bashkëpunimin civil-ushtarak ose në operacionet e veçanta janë rezervistë dhe kanë aftësi më të mira se forcat aktive.

Ndërsa në disa vende, si në SHBA, Angli, etj., forcat rezervë vullnetare përbëhen kryesisht nga ish-ushtarakë të shërbimit aktiv profesionist pas daljes së tyre në rezervë. Ky detyrim për të shërbyer në përbërje të rezervës vullnetare parashikohet qysh në kontratën e hyrjes së tyre në shërbimin aktiv të shumë vendeve të 31 vendeve të Aleancës. Po ashtu, në vendet e NATO-s, rezervistë mund të jenë edhe nga shoqëria civile, të cilët dëshirojnë vullnetarisht të kontribuojnë në FA.

Kush mundet të jenë raportet mes forcës aktive dhe Rezerviste? Nga 31 vende anëtare të NATO-s, më shumë se 20, si p.sh: Gjermania, Italia, Greqia, Bullgaria, Polonia, Spanja, Portugalia, vendet Baltike etj., numri i forcave rezervë është shumë më i madh se ai i forcave të rregullta.

Ndërsa në SHBA njësitë luftarake rezerviste janë atashuar në Gardën Kombëtare. Me rreth 20 % të njësive të Ushtrisë së SHBA-së dhe 5,3 % të buxhetit të saj, forcat rezervë sigurojnë rreth 50 % të mbështetjes së luftimit në operacione.

Një avantazh tjetër është se ata janë shumë më pak të kushtueshëm se forca aktive, gjë që lidhet me kohën e pjesshme të shërbimit të tyre, dhe vetëm me nevojat specifike të përdorimit të tyre. Gjithsesi forca vullnetare rezerviste nuk mund të përdoren për të gjithë spektrin e misionit të Forcave të Armatosura.

Sa mund të përdoret rezerva vullnetare? Duke eksploruar eksperiencat e vendeve të tjera, për rastin e vendit tonë, nuk bëhet fjalë për të rekrutuar ushtarë nga shoqëria civile për të plotësuar togat apo kompanitë e FA-së, apo të ngjashme të nivelit bazë, por vetëm për plotësimin me ato kapacitete të nevojshme cilësore që ose kemi me pakicë, ose nuk kemi fare në FA ose që na duhen në periudha të caktuara.

Cili mund të jetë misioni i forcave Rezervë?

Teorikisht, spektri i misionit të forcave rezervë mund të jetë gjithëpërfshirës, pra nga ato paqeruajtëse deri në luftarake, por prioritet mbeten operacionet në mbështetje të paqes të drejtuara nga NATO/BE/OKB, si dhe në emergjencat civile kombëtare.

Së treti: disa konsiderata dhe rekomandime strategjike për një forcë vullnetare rezervë të FA-së të Shqipërisë?

Na duhet ta qartësojmë edhe më tej se, nuk bëhet fjalë për nostalgji mbi forcën rezervë klasike, dhe aq më shumë, nuk bëhet fjalë fare për konceptin e forcës rezervë të sistemit komunist të mbrojtjes me forcat e veta të çdo pëllëmbë të territorit dhe ku çdo qytetar ishte presupozuar ushtar. Sot ky model aplikohet nga Koreja e Veriut dhe ndoshta Xhibudi.

Përkundrazi, mbas anëtarësimit në sistemin e mbrojtjes kolektive (NATO), RSH ka detyrimin të aplikojë një model të ri të forcës rezervë vullnetare në kushtet e mjedisit të ri të sigurisë, pra një forcë e arsyeshme, e leverdishme dhe e (shumë) përdorshme në operacionet brenda dhe jashtë vendit.

Forca e ardhshme rezervë shqiptare duhet të përfitojë nga eksperiencat më të mira të vendeve të Aleancës. Sigurisht do të jetë një forcë e vogël, e bazuar në prioritetet të specializuara, e leverdishme

dhe e gatshme për mbështetjen e forcës aktive profesioniste.

Normalisht, nuk mund të pritet as planifikohet që komponenti i ardhshëm rezervë të kryejë të gjitha misionet dhe detyrat që kryejnë forcat profesioniste aktive, por Ato mund të kryejnë me shumë sukses një pjesë të detyrave të tyre, pse jo, me cilësi edhe më të lartë se forca aktive, sidomos ato në fushën e emergjencave civile.

Forca rezervë është e bazuar në kushtetutën e RSH, ku në nenin 166 shprehet që "shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e RSH...". Prandaj, me të drejtë parimi kryesor i këtij komponenti mbetet zhvillimi i një force rezervë e tipit vullnetar dhe jo të rekrutimit të detyrueshëm.

Por me gjithë dëshirën Euro-Atlantike dhe të drejtën kushtetuese, komponenti rezervë, ashtu si ai aktiv, nuk mund të jetë aq "universal" sa për të pranuar çdo shtetas që e kërkon një "të drejtë" të tillë. Sigurisht, çdo shtetas duhet t'i respektohet e drejta kushtetuese të aplikojë, por bazuar në kriteret profesionale dhe në nevojat konkrete të strukturave të FA-së, vetëm një pjesë shumë e vogël të tyre mund t'u plotësohet kërkesa e pjesëmarrjes në forcën rezervë.

Një kuadër i ri ligjor

Është shumë e rëndësishme, që ngritja e komponentit rezervë të mbështetet me një kuadër ligjor të avancuar. Forca rezervë vullnetare ose bëhet ose nuk bëhet funksionale, ajo nuk bëhet përgjysmë. Kjo do të thotë që nëse po ndërtojmë një elitë profesioniste ushtarake aktive, duhet ta ndërtojmë gjithashtu një elitë të tillë edhe forcën rezervë vullnetare.

Çfarë force rezervë i duhet RSH?

Forca rezervë mund të plotësohet kryesisht (por jo vetëm) nga kontingjentet e personelit të FA-së mbas mbarimit të shërbimit aktiv, duke nënshkruar që në hyrjen në shërbimin profesionist për të vijuar shërbimin në rezervë deri 3 - 6 vjet.

Po ashtu, në forcën rezervë vullnetare mund të rekrutohen edhe kontingjentet e dëshiruara të shoqërisë civile, të cilat disponojnë kualitet të lartë specialitetesh që mund t'i nevojiten FA-ve në periudha dhe operacione të caktuara.

Një parim tjetër themelor i komponentit rezervë mund të jetë që ai duhet të shihet si komponent operacional, i integruar i njësive ushtarake. Kjo do të thotë që forca rezervë, përveç rasteve të rralla, nuk duhet të jetë e organizuar mbi bazë njësishe apo repartesh kompakte rezervë, përkundrazi, komponenti rezervë duhet të jetë i integruar së bashku me forcën profesioniste aktive, në një përqindje të caktuar që nuk pengon por e plotëson shkallën e gatishmërisë së pranuar të njësive për mision.

Bazuar në eksperiencat e vendeve të NATO-s, forca rezervë mund të shkojë deri 20 %. Por, nuk përjashtohet mundësia e ndërtimit me komponent dominues rezervë të kapaciteteve "niche" të FA-së, sidomos në emergjencat civile, si dhe në operacionet paqe-ndërtuese ndërkombëtare.

Thënë këtë, besoj se është logjike se, një prezencë më të madhe të komponentit rezervë në forcën tokësore, krahasuar me forcën detare dhe ajrore si dhe në specialitetet në elementët mbështetës të tipit "enabling", se sa në forcat e luftimit.

Për ilustrim, mund të marrim një nga detyrat kryesore të misionit të FA-së: "sigurimi i hapësirës ajrore të RSH". Përveç komponentit profesionist aktiv që mund të kemi në Forcën Ajrore, mund të rekrutojmë edhe komponent civil rezervë vullnetar nga Agjencia e Kontrollit të Hapësirës Ajrore të RSH, e cila ka ekspertizë dhe eksperiencë të spikatur, dhe vetëm me një trajnim në kohë të pjesshme mbi sistemin ushtarak dhe sistemin NATINADS të Aleancës, mund të jetë shumë i vlefshëm edhe për misionin e Forcave Ajrore. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sistemin e vëzhgimit të Hapësirës Detare. Po kështu, mund ta zgjerojmë listën edhe me shfrytëzimin e kapaciteteve kombëtare kundër efekteve të ASHM, të kapaciteteve xheniere, të kapaciteteve për emergjencat civile, të luftës kundër terrorizmit, etj.

Si mund të trajnohet rezerva vullnetare?

Sipas përvojës së vendeve të Aleancës, forca rezervë vullnetare trajnohet rregullisht çdo vit dhe paguhen me rreth 80-100 për qind të pagës së forcave të rregullta aktive. Një variant i trajnimit të forcës rezervë mund të jetë 30-45 ditë trajnimi në vit.

Sa mund të jetë numri i forcës vullnetare rezervë të FASH?

Gjykoj që për rastin e RSH, pra një forcë profesioniste aktive prej më pak se 10 mijë vetë (pa përfshirë personelin e Emergjencave Civile), mund të vlerësohet zhvillimi i një force rezervë vullnetare prej mbi 1 mijë vetë, pra rreth 20 % të forcës aktive.

Në shtesë, më duhet gjithsesi ta theksoj që për sa në disa dhjetëra vlerësimet dhe rekomandimet strategjike, përfshi në këtë rast, nuk pretendoj kurrësi të jenë të vërteta të fundit ose EUREKA, por një përpjekje modeste për të kontribuar me eksperiencën dhe ekspertizën Euro-Atlantike edhe për këtë projekt.

Lufta e BE-së kundër krimit mjedisor

Krimi mjedisor është një nga aktivitetet kriminale të organizuara më fitimprurëse në botë dhe ka një ndikim të madh jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njerëzve. Është shumë fitimprurës, por është e vështirë për ta zbuluar, ndjekur penalisht dhe dënuar atë. Këta faktorë e bëjnë atë shumë tërheqës për grupet e krimit të organizuar.

BE-ja ka ndërmarrë veprime për të luftuar rrjetet kriminale të përfshira në të gjitha format e krimit mjedisor, duke përfshirë futjen e rregullave për menaxhimin e mbetjeve dhe për tregtinë e kafshëve të egra dhe bimëve. BE-ja po punon gjithashtu në forcimin e rregullave ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal.

Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe doganat në të gjitha vendet e BE-së, institucionet, agjencitë dhe organet e BE-së, si dhe vendet dhe organizatat partnere, punojnë së bashku për të luftuar këtë formë krimi përmes hetimeve, konfiskimeve dhe operacioneve të tjera policore.

Presidenca e Këshillit dhe negociatorët e Parlamentit Evropian arritën një marrëveshje të përkohshme mbi një ligj të propozuar të BE-së që do të përmirësonte hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të krimit mjedisor.

Direktiva e re synon vendosjen e rregullave minimale për përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve me qëllim mbrojtjen më të mirë të mjedisit, duke zëvendësuar direktivën e mëparshme të vitit 2008, e cila është vjetruar përballë zhvillimeve në ligjin mjedisor të BE-së.

Direktiva përcakton më saktë krimin mjedisor dhe shton lloje të reja të veprave penale mjedisore. Ai gjithashtu harmonizon nivelin e dënimeve për personat fizikë dhe, për herë të parë, për personat juridikë në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.



dhe thelbësor për një ekosistem me përmasa të konsiderueshme ose vlerë mjedisore, ose për një habitat natyror brenda një zone të mbrojtur, ose për cilësinë e ajrit, tokës ose ujit.

parashikon dënimet e mëposhtme:

- Për vepra me dashje që shkaktojnë vdekjen e një personi, një dënim maksimal prej së paku dhjetë vjet burg;

- Për veprën e cilësuar që shkakton rezultate katastrofike, një dënim maksimal me burgim prej të paktën tetë vjetësh;

- Për veprat e kryera nga të paktën pakujdesia e rëndë që i kanë shkakuar vdekjen çdo personi, një dënim maksimal me burgim prej të paktën pesë vjetësh;

- Për vepra të tjera të qëllimshme të përfshira në legjislacionin, një dënim maksimal prej të paktën pesë vjetësh ose të paktën tre vjetësh.

Në rastin e personave juridikë, ligji parashikon dënimet e mëposhtme:

- Për veprat më të rënda, një gjobë maksimale prej të paktën 5% të xhiros totale të personit juridik në mbarë botën, ose 40 milionë euro.

- Për të gjitha shkeljet e tjera, një gjobë maksimale prej të paktën 3% të xhiros totale të personit juridik në mbarë botën, ose 24 milionë euro.

Mund të merren gjithashtu masa shtesë, duke

sigurojnë që të ofrohet trajnim për ata që punojnë për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit mjedisor, si gjyqtarët, prokurorët dhe autoritetet policore. Vendet e BE-së do të duhet gjithashtu të sigurohen që këto autoritete të kenë burime të përshtatshme – për shembull për sa i përket numrit të stafit të kualifikuar dhe burimeve financiare për të kryer funksionet e tyre sipas direktivës. Direktiva përmban gjithashtu dispozita për mbështetjen dhe ndihmën ndaj personave që raportojnë krimin mjedisor, mbrojtësve të mjedisit dhe personave të prekur nga këto krime.

Krimi mjedisor është një nga aktivitetet kriminale të organizuara më fitimprurëse në botë dhe ka një ndikim të madh jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njerëzve. Është shumë fitimprurëse, por është e vështirë për t'u zbuluar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar.

Një direktivë e parë e BE-së për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal u miratua në vitin 2008. Pas një vlerësimi në 2019-2020, Komisioni Evropian arriti në përfundimin se efekti i direktivës ishte i kufizuar pasi numri i



Më shumë shkelje...

Këshilli dhe Parlamenti Evropian ranë dakord të rrisin numrin e veprave që ekzistojnë aktualisht sipas ligjit penal të BE-së nga nëntë në 18. Kjo zgjeron dhe sqaron llojin e sjelljes që është e ndaluar sepse dëmton mjedisin. Veprat e reja përfshijnë trafikimin e lëndës drusore, i cili është shkaku kryesor i shpyllëzimit në disa pjesë të botës, riciklimi i paligjshëm i përbërësve ndotës të anijeve dhe shkelje të rënda të legjislacionit për kimikatet. Këshilli dhe Parlamenti Evropian ranë dakord gjithashtu për një klauzolë të 'veprës së kualifikuar'. Veprat e përmendura në direktivë dhe që kryhen me dashje, konsiderohen si vepër e cilësuar nëse shkaktojnë shkatërrim; dëme të pakthyeshme, të përhapura dhe të konsiderueshme; ose dëmtim afatgjatë, i përhapur

... dhe dënime më të ashpra

Në rastin e personave fizikë që kryejnë një nga veprat penale të përfshira në direktivë, teksti



përfshirë detyrimin e shkelësit për të rivendosur mjedisin ose për të kompensuar dëmin, duke i përjashtuar ata nga aksesin në fondet publike ose duke tërhequr lejet ose autorizimet e tyre.

Trajnimi dhe burimet

Përveç kësaj, shtetet anëtare do të duhet të

rasteve të hetuara me sukses dhe që rezultoi në një dënim mbi të ulët. Për më tepër, nivelet e sanksioneve të vendosura ishin shumë të ulëta për të qenë bindëse dhe bashkëpunimi ndërkuftar nuk po zhvillohej sistematikisht. Më 15 dhjetor 2021, Komisioni paraqiti një propozim për të përmirësuar efektivitetin e direktivës.

Inteligjenca artificiale e re mund të imitojë trurin e njeriut, të përdorë të njëjtat truke si ne

Shkencëtarët në Universitetin “Cambridge” në Mbretërinë e Bashkuar kanë krijuar një sistem të vetë-organizuar, artificialisht inteligjent që përdor të njëjtat truke si truri i njeriut për të zgjidhur detyra specifike.

Ky zbulim jo vetëm që lejon zhvillimin e rrjeteve nervore më efikase brenda fushës së mësimin të makinerive, por gjithashtu mund të ofrojë njohuri të reja në funksionimin e brendshëm të vetë trurit të njeriut. Një nga autorët e studimit tha se ishin shumë të befashuar nga rezultatet.

Truri i njeriut dhe organet e tjera komplekse zhvillohen nën një sërë kufizimesh dhe kërkesash konkurruese. Për shembull, rrjetet tona nervore duhet të optimizohen për përpunimin e informacionit, por të mos përdorur shumë energji ose burime. Këto shkëmbime formojnë trurin tonë për të krijuar një sistem efikas që funksionon brenda këtyre kufizimeve fizike.

“Sistemet biologjike zakonisht evoluojnë për të shfrytëzuar sa më shumë burimet energjetike që kanë në dispozicion”, - tha në një deklaratë bashkautorit Danyal Akarca, nga Njësia e Njohjes dhe Shkencave të Trurit të Këshillit të Kërkimeve Mjekësore në Universitetin “Cambridge”. “Zgjidhjet në të cilat ata vijnë janë shpesh shumë elegante dhe pasqyrojnë shkëmbimet midis forcave të ndryshme që u janë imponuar.”

Së bashku me autorin bashkë-udhëheqës Jascha Achterberg, një neuroshkencëtar llogaritës nga i njëjti departament, Akarca dhe ekipi i tij krijuan një sistem artificial me kufizime fizike të imponuara që synonin të modelonin një version të thjeshtuar të trurit. Rezultatet e tyre u publikuan në revistën “Nature Machine Intelligence” më 20 nëntor.

Truri ynë përbëhet nga një rrjet kompleks i qelizave të trurit të ndërlidhura të quajtura neurone. Këto neurone lidhen së bashku për të formuar autostrada informacioni që përhapen në zona të ndryshme të trurit. Në vend të përdorimit të neuroneve reale, sistemi i AI-së i ekipit përdori nje llogaritëse, secilit i dhanë një vendndodhje specifike në hapësirën virtuale. Dhe, si neuronet tona, sa më larg të ishin dy nyjat, aq më e vështirë ishte për ta të komunikonin. Më pas sistemit iu kërkua të kryente një detyrë labirint që kërkon të dhëna të shumta dhe përpunim informacioni për t’u zgjidhur.

“Ky kufizim i thjeshtë i detyron sistemet artificiale të prodhojnë disa karakteristika mjaft të ndërlikuara”, - tha në një deklaratë bashkautorit Duncan Astle, një profesor nga Departamenti i Psikiatrisë në “Cambridge”. “Është interesante, ato janë karakteristika të përbashkëta nga sistemet biologjike si truri i njeriut. Mendoj se kjo na tregon diçka thelbësore se pse truri ynë është i organizuar ashtu siç është.”

Me fjalë të tjera, kur sistemi u vu nën kufizime fizike të ngjashme me ato të aplikuar në trurin e njeriut, ai filloi të përdorte disa nga truket e njëjta të përdorura nga truri i vërtetë i njeriut për të zgjidhur këtë detyrë specifike.

“Ne ishim shumë të befashuar nga rezultatet tona. Sistemi i AI-së që ne krijujmë në punën tonë është i ngjashëm me trurin në shumë mënyra. Shumë tipare që përshkruajmë në punimin tonë mund të grupohen përafërsisht në dy grupe.

Sistemi AI tregon një strukturë të brendshme të ngjashme me trurin e njeriut. Kjo do të thotë se mënyrat se si lidhen pjesët individuale dhe neuronet e AI-së janë të ngjashme me mënyrën se si lidhen pjesët të ndryshme në trurin e njeriut. Sistemi AI tregon në mënyrë specifike një instalim të brendshëm shumë “të ngjashëm me trurin” dhe me efikasitet energjie.

Sistemi AI tregon gjithashtu funksione të brendshme të ngjashme me trurin e njeriut. Kjo do të thotë se sinjalet e krijuara nga neuronet për të dërguar informacione nëpër lidhjet e sistemit AI duken shumë të ngjashme me sinjalet që vëzhgojmë në tru. Përsëri, sinjalet e trurit mendohet se janë një mënyrë shumë efikase për



dërgimin e informacionit.”

Ekipi shpreson që sistemi i tyre i AI-së mund të zhvillohet për të hedhur dritë mbi mënyrën se si kufizimet specifike kontribuojnë në ndryshimet që shohim në trurin e njeriut, veçanërisht ato që shihen te njerëzit që luftojnë me vështirësitë e shëndetit njohës ose mendor.

“Këta tru artificialë na japin një mënyrë për të kuptuar të dhënat e pasura dhe hutuese që shohim kur aktiviteti i neuroneve reale regjistrohet në trurin e vërtetë”, - tha John Duncan.

Achterberg tha se: “Ne tregojmë se marrja në konsideratë e aftësive të trurit për zgjidhjen e problemeve së bashku me qëllimin e tij për të shpenzuar sa më pak burime të jetë e mundur mund të na ndihmojë të kuptojmë pse truri duket si duket.

“Truri” artificial na lejon të bëjmë pyetje që do të ishte e pamundur t’i shikojmë në një sistem aktual biologjik. Ne mund ta trajnojmë sistemin për të kryer detyra dhe më pas të luajmë eksperimentalisht me kufizimet që vendosim, për të parë nëse ai fillon të duket më shumë si truri i individëve të veçantë.

“Kërkimi ynë sugjeron fuqishëm se ndërsa truri ka të gjitha këto karakteristika dhe veçori shumë komplekse që ne vëzhgojmë nëpër studime brenda neuroshkencës, mund të ketë parime shumë të thjeshta themelore që shkaktojnë të gjitha këto karakteristika komplekse.”

Gjetjet e tyre mund të kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin e sistemeve më efikase të AI-së, veçanërisht ato që duhet të përpunojnë sasi të mëdha informacioni që ndryshojnë vazhdimisht me burime të kufizuara energjetike.

“Kërkuesit e AI-së janë vazhdimisht duke u përpjekur të gjejnë se si të bëjnë sisteme komplekse nervore që mund të kodojnë dhe performojnë në një mënyrë fleksibël që është efikase”, - tha Akarca. “Për ta arritur këtë, ne mendojmë se neurobiologjia do të na japë shumë frymëzim. Për shembull, kostoja e përgjithshme e instalimeve elektrike të sistemit që kemi krijuar është shumë më e ulët se sa do të gjenit në një sistem tipik AI.”

Achterberg tha: “Truri i robotëve që janë të vendosur në botën reale fizike ndoshta do të duket më shumë si truri ynë, sepse ata mund të përballen me të njëjtat sfida si ne. Ata duhet të përpunojnë vazhdimisht informacionin e ri që vjen përmes sensorëve të tyre ndërsa kontrollojnë trupat e tyre, për të ecur nëpër hapësirë drejt një

qëllimi. Shumë sisteme do t’ju duhet të kryejnë të gjitha llogaritjet e tyre me një furnizim të kufizuar të energjisë elektrike dhe kështu, për të balancuar këto kufizime energjetike me sasinë e informacionit që duhet të përpunojë, ndoshta do të ketë nevojë për një strukturë truri të ngjashme tek tonat”.

Truri artificial gjithashtu ka nevojë për pushim



Studiuesit e Laboratorit Kombëtar të Los Alamos zbuluan se sistemet përfitonin nga një analog artificial i gjumit.

Inteligjenca artificiale është ende shumë larg nga përputhja me inteligjencën njerëzore, por një mënyrë që mund të pasqyrojë tashmë njerëz të thjeshtë është nevoja e saj për gjumë.

Studiuesit nga Laboratori Kombëtar i Los Alamos e bënë zbulimin gjatë zhvillimit të rrjeteve nervore që mësojnë në mënyrë të ngjashme si truri i njeriut.

Ata zbuluan se truri artificial u bë i paqëndrueshëm pas periudhave të vazhdueshme të trajnimit të fjalorit të pambikëqyrrur. Kjo teknikë përfshin klasifikimin e objekteve pa i krahasuar ato me shembujt ekzistues, gjë që do të ishte mjaft rraskapitëse.

Ata u përpoqën të kapërcenin problemin duke i ekspozuar rrjetet ndaj sinjaleve të zhurmës që krijuan një version artificial të gjumit. Kur ata përdorën zhurmën “Gaussian”, e cila përfshin

një gamë të gjerë frekuencash dhe amplitudash, stabiliteti u rivendos.

Studiuesit besojnë se kjo zhurmë imiton inputin e marrë nga truri i njeriut gjatë gjumit me valë të ngadalta, një fazë e thellë e gjumit që është thelbësore për një shëndet të mirë.

“Ishte sikur po u jepnim rrjeteve nervore ekuivalentin e një pushimi të mirë të natës”, - tha shkencëtari kompjuterik i Laboratorit Kombëtar

të Los Alamos, Yijing Watkins.

Studiuesit thonë se kjo nevojë për pushim nuk është e kudondodhur në AI. Në vend të kësaj, është i kufizuar në procesorë neuromorfikë biologjikisht realistë, siç është çipi “Loihi” i Intel.

Garrett Kenyon, bashkautorit i studimit të Los Alamos, tha: “Shumica dërrmuese e studiuesve të mësimin të makinerive, mësimin të thellë dhe AI-ja nuk e hasin kurrë këtë problem, sepse në sistemet shumë artificiale që ata studiojnë ata kanë luksin e kryerjes së operacioneve globale matematikore që kanë efektin e rregullimit të përfitimt të përgjithshëm dinamik të sistemit.

Ekipi i tij tani synon të aplikojë sistemin e tyre në Loihi, për të ndihmuar çipin të përpunojë informacionin në kohë reale nga një kamera e retinës.

Ata gjithashtu mendojnë se androidët e ardhshëm mund të përfitojnë nga këto cikle të ngjashme me gjumin. Ndoshta njerëzit, punët e të cilëve zëvendësohen nga AI-ja, mund të mbulojnë robotët, kur kanë nevojë për një sy gjumë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Udhëtim nëpër Shqipëri

Nga Korça, kur mora rrugën për në Tepelenë, mora me vete kureshtjen dhe interesimin së bashku me vetëdijen se po shkoja në një qytet me vlera historike, krahina me burra trima dhe patriotë të pasqorë.

Për të shkuar nga Tepelena në Korçë, në atë kohë, ishte e detyruar të shkoje në Gjirokastrë një ditë më parë, të pajisesh me biletë udhëtimi me autobus, për ditën e nesërme dhe një natë të flije në qytetin e Gjirokastrës. Një herë në javë, ditëve të enjte, një autobus i prodhimit çek, me 52 pasagjerë, nisej herët në mëngjes nga Gjirokastra, rrugëtonte gjithë ditën nëpër rrugën e pa shtruar e me gropa, kalonte në Këlcyrë, Përmet, Leskovik, Ersekë dhe në mbrëmje soste në Korçë. Pasagjerët ishin të detyruar të qëndronin gjithë ditën në karriget përkatëse, ku lodheshin e vuanin pisërinë e zezë. Ndërsa sot, komoditeti infrastrukturor ka bërë që këto distanca “të largëta” t’i bëjë të afërta dhe të aksesueshme për cilindo që kërkon të shijojë bukuritë shqiptare.

Tepelena ka një pamje që të tërheq dhe të imponohet. Begatinë këtij vendi ia shton uji dhe pastërtia.

Fshati Dukaj ishte destinacioni i radhës. Sa shumë histori deri në mitizim kishte ky vend. Mikpritësi ynë na jep detaje të përziera me dashuri vendlindjeje nga ato që dhembin, sidomos kur je larg dhe aty rikthehesh prej mallit të të parëve.

Shqipëria, sa vende mahnitëse dhe çfarë lidhje shpirtërore janë krijuar me këto vende, të cilat ta kthejnë gjithmonë kokën pas. Te ai gjelbërim, tek ato histori deri tek gjeneza pellazge.

Tepelena dhe kënga, pasuria e saj folklorike. Pas kaq hulumtimesh, jam bindur se Vendlindja juaj, miq tepelanas, është një kryeqendër folklorike, një thesar i çmuar i artit popullor dhe ndoshta një nga margaritarët më të rrallë në thesarin e kulturës sonë kombëtare në fushën e trashëgimisë popullore. Mbetet një çudi më vete dhe për t’u studiuar seriozisht, se cilat janë arsyet që njerëzit e kësaj ane kanë krijuar kaq shumë perla folklorike, duke shkruar me to historinë e jetës, të luftërave dhe ngjarjeve të këtij vendi.

Këngë kushtuar atyre mijëra djemve e vajzave që ranë në lulen e rinisë, për të bërë Shqipërinë e re.

Tepelenën ndryshe do e pagëzoja “Qyteti i një mbi një kalave”. Dhe veç duke parë këto fortifike kupton dhe rëndësinë e saj historike.

Kalaja e Tepelenës, e shpallur Monument Kulture i kategorisë së parë në vitin 1963 ndodhet në veri të qytetit të Tepelenës. Sipas burimeve historike, kalaja ishte projektuar nga vetë Ali Pashë Tepelena, i cili kishte mbikëqyrur fazat e para të ndërtimit të këtij simboli heroik të rajonit. Kalaja ekzistuese u rindërtua prej tij në vitin 1819 me një sipërfaqe prej 5,5 ha, me tre hyrje dhe tre kulla. Deri në vitin 1820 është përdorur si rezidenca e dytë e Ali Pashë



Tepelenës. Muret e kështjellës janë ngjitur në formën natyrale të tokës dhe nuk përbëhen nga një formë e rregullt gjeometrike. Në kthesat kryesore të mureve janë vendosur tre kulla poligonale, për t’i kontrolluar më mirë ato. Kalaja ka tre porta, njëra prej të cilave (lindore) mban mbishkrimin “Porta e Vezirit”

Kalaja e Qytezës

Kalaja e qytezës ndodhet në kodrën afër fshatit Dukaj, 300m mbi nivelin e detit. Kalaja ka formën e një katërkëndëshi të rregullt që mbulon një sipërfaqe 0.5 ha. Ky qytet i vogël i përket periudhës IV-III, p.e.s. Në pjesën më të madhe të saj është e mbrojtur shumë mirë nga natyra dhe gjithashtu është e fortifikuar mjaft mirë nga muret e fuqishëm në pjesët e hapura natyrore. Kalaja ka qenë e pajisur me tri kulla, muret e të cilave janë mbështetur në shkëmbin e gdhendur me qëllimin për të shmangur rrëshqitjet.

Kalaja e Leklit

Kalaja e Leklit është një tjetër monument kulture i kategorisë së parë i mbrojtur nga shteti. I përket shekullit IV para Krishtit. Kalaja e Leklit qëndron në kodrën e quajtur Shën Mëhill në pjesën perëndimore të malit Golik. Kodra shkëmbore ku ndodhet kalaja është zgjedhur për pozicionin e saj strategjik për të kontrolluar të gjitha shtigjet dhe rrugët që lidhin Ilirinë me Epirin, të cilat në antikitet njihen si Ngushticat e Antigonesë. Këto përmenden në luftërat e fundit të shekullit III – V p.e.s. Nga Kalaja e Leklit ishte e lehtë të kontrollohej hyrja veriore në Luginën e Drinosit të të gjithë trupave të luftës. Kalaja e Leklit ka tërhequr vëmendjen e arkeologëve të ndryshëm si Hamondi dhe Ugolini të cilët e vizituan atë në shekullin e 20-të. Edhe arkeologët shqiptarë kanë nisur gërmimet pranë kalasë së Leklit në vitin 1948, dhe kjo vazhdoi derisa zbuluan qytetin e Antigonesë nga





Dhimosten Budina në kodrën e Jermes, Saraqinisht. Antigonea ishte një zonë arkeologjike e kompletuar dhe e fuqishme dhe që nga ai moment Kalaja e Leklit mbeti pas dhe nuk janë bërë më punë gërmimi. Megjithatë nuk ka një pamje të qartë të formës së Kalasë së Leklit.

Kalaja Matohasanaj

Kalaja antike e Matohasanajt ndodhet në majën e një kurrizi shkëmbor, i cili ngrihet në qendër të luginës së Sinanajt, midis shtratit të lumit Vjosa dhe malit të Gribës. Kalaja i përket shek. V p.e.s dhe ka gjurmë të vazhdimet të jetës thujse në çdo periudhë në vijim. Muret e kalasë rrethojnë një sipërfaqe rreth 3 ha, sipërfaqe e përbërë nga radhë tarracash të përshtatshme për banim. Muret rrethuese u përkasin tri periudhave të ndryshme ndërtimi, dy periudhat e para përfaqësojnë periudhën e Antikitit në këtë qytet, ndërsa periudha e tretë e ndërtimit përfaqëson Antikitin e vonë.

Kalaja e Nivicës

Rrënojat e kalasë së Nivicës ndodhen majë një shkëmbi të thepisur, rrethuar nga humnera, me thellësi 200-400 metra. Nga tre anë ka një mbrojtje natyrale, ndërsa vetëm nga Perëndimi është e mbrojtur nga një mur guri me llaç gëlqereje me gjerësi mbi një metër. Deri vonë është ruajtur një portë e brendshme me qemer, ndërtuar me gurë të latuar me gjatësi 0,5-1 metra, të nxjerra nga shkëmbinjtë e zonës. Në krahun lindor dallohet një udhë pothuajse shkallore që zbret në drejtim të lumit nëpërmjet një porte të çarë në shkëmb. Këto shkallare lidhin kalanë me lumin si dhe me dy mullinj që funksiononin nëpërmjet një vije uji që rridhte nga një e çarë në shkëmb. Me sa duket, ky ishte edhe shtegu i furnizimit të kalasë në raste rrethimesh. Kalaja është ndërtuar mbi një shkëmb të pamundur t'i afrohesh, në një kryqëzim strategjik rrugësh. Këtu kalon rruga e Vermikut, ajo e Salarisë, e Kuçit dhe e Bënçës. Sipas francezit Pouqueville, këtu ka banuar fisi ilir i Amantëve, të cilët kanë qenë të parët që kanë ndërtuar kalanë në shek. IV para Krishtit. Pas kësaj mendohet se Nivica është shndërruar në qendrën e dytë të banuar për fisin e Amantëve. Të dhënat arkeologjike tregojnë se qyteti arriti kulmin e lulëzimit në shekujt III-I para Krishtit, ndërsa kronistët osmanë të periudhës së luftërave shqiptaro-turke bëjnë fjalë për një qytet me 500-600 shtëpi. Kalaja u rindërtua në periudhën e sundimit bizantin me urdhër të perandorit Justinian, i cili i kushtoi një rëndësi të veçantë fortifikimeve ushtarake në Arbëri. Në periudhën e dyndjeve sllave dhe më pas gjatë pushtimit osman, kalaja e Nivicës ka qenë një teatër i rëndësishëm i luftimeve, duke qenë e zaptuar herë prej vendasve dhe herë prej të huajve.

Kalaja e Zharrës

Kjo kala ngrihet në majën e kodrës shkëmbore me të njëjtin emër dhe me lartësi 310 m. Kodra ndodhet në perëndim të qytetit të Tepelenës në anën e majtë të luginës së Vjosës dhe duke u zgatur nga jugu në veri merr formën e hundës. Nga ky pozicion mund të kontrollohen rrugët që kalojnë në këtë anë të luginës së Vjosës. I pari që e ka vizituar kalanë e Zharrës ka qenë Pouqueville, sipas të cilit kjo kala është vepër e latinëve, më pas është vizituar dhe përmendur nga H. Holland. Nga arkeologët shqiptarë ka qenë H. Ceka i pari që e ka vizituar, ka përshkruar gjendjen e rrënojave dhe është shprehur për kohën e ndërtimit të saj. Më pas në vitin 1963 është bërë një ekspeditë informative, me qëllim njohjen e gjendjes së monumentit. Gërmimet e para në këtë kala janë bërë në vitin 1970. Këto gërmime janë drejtuar nga D. Komata. Kjo kala i përket periudhës së Antikitit të Vonë (shek. IV-VI e. sonë) dhe mendohet se mund të jetë një nga fortifikimet e Justinianit I për funksionim ushtarak. Muri ndjek format e relievit të kalasë mbi të cilën është ngritur, duke marrë formën e një elipsi të zgatur me perimetër 410 m dhe rrethon një sipërfaqe prej 0.8 ha. Ai ndiqet në

gjithë gjatësinë e tij edhe pse në disa pjesë është dëmtuar dhe rrëzuar plotësisht. Lartësia më e madhe e tij është 2.8 - 2.9 m. Trashësia e murit varion nga 1.6 m në 1.8 m. Për ndërtimin e tij janë përdorur gurë gëlqerorë mesatarë, të cilët janë të punuar ose të pa punuar dhe me forma dhe përmasa të ndryshme.

Ura mesjetare e Beçishtit – Ali Pashë Tepelenës

Kjo urë antike-mesjetare ndodhet poshtë kalasë së Tepelenës mbi lumin Vjosë. Njihet ndryshe si Ura e Beçishtit. Kjo urë ka gjurmë të periudhës romake, gjysmës së parë të shek. të 1-rë, para Krishtit. Gjatë kohës mesjetare ajo u rindërtua mbi bazat e urës romake. Më pas u restaurua nga Ali Pashë Tepelena, në shek. XVII pas Krishtit. Ura është 260 m e gjatë. Ura e Beçishtit, e ndërtuar në kohën e Ali Pashës lidh Tepelenën me 7 fshatra. Mendohet se fshati Beçisht



është dhe vendi ku ka lindur Ali Pasha. Edhe sot në fshat ndodhen rrënojat e shtëpisë së tij

Uji i Ftohtë i Tepelenës

E si mund të largoheshim prej këtyre kalave me histori trimash pa vizituar një prej atraksioneve më të bukura, bekuar nga zoti, Uji i Ftohtë. Miku ynë, bir i kësaj krahine, na sugjeroi: "Pini pak ujë nga këto burime dhe trupi juaj do t'ju jetë falënderues", dhe kishte të drejtë. Gjithçka ishte si e pikturuar, tablo reale e resurseve shqiptare.

Uji i Ftohtë, kjo zonë turistike 8 km në jug qytetit të Tepelenës, ka marrë emrin "Uji i Ftohtë" sepse zona është e mbizotëruar nga burime natyrore-shkëmbore, ku uji rrjedh gjithmonë i ftohtë dhe i pastër. Burimi ekziston prej më shumë se 250 vjetësh dhe është gërmuar në shkëmbinjtë e maleve të Tepelenës, qytet i qetë në jug të Shqipërisë dhe atdheu i Ali Pashës, personazh historik që ka jetuar midis viteve 1700 dhe viteve 1800, të cilit i njihet edhe zbulimi i burimit. Falë pasurisë nëntokësore të kësaj zone, në Ujin e Ftohtë marrin jetë dhjetëra burime të kristalta, të cilët "ushqejnë" rrjedhën e lumit Vjosë. Shpati ku del burimi është i



veshur me bimësi natyrore të dushkut dhe shkurreve. Parku natyror i Ujit të Ftohtë përbëhet nga një bimësi mjaft e pasur e llojeve të ndryshme. Krahas shkurreve, në të mbizotëron edhe druri i rrapit apo edhe shelgu. Në afërsi të luginës, drurët e rrapeve janë mjaft të rritur. Ndërkohë përgjatë sipërfaqes së parkut natyror hasen edhe



gjallesha dhe kafshë të ndryshme tipike për këtë zonë. Uji i Ftohtë në Tepelenë ka vlera shkencore (hidrologjike, gjeomorfologjive), estetike e turistike.

Ujëvara e Peshturës

Ujëvara e Peshturës ndodhet në Progonat të Tepelenës e për të shkuar atje duhet të kalohet përmes malësive të Tepelenës. Zona përbëhet nga shkëmbinjtë gëlqerorë të cilët në shekuj janë përshkruar nga

përrenj të vrullshëm dhe lozonjarë. Forma të shumta karstike, gropa të thella, shpella të shumta dhe ujëvara është peizazhi që ofron rruga për të shkuar drejt Ujëvarës së Peshturës

Kanionet e Nivicës

Kanionet e Nivicës ndodhen në afërsi të fshatit Nivicë të rrethit të Tepelenës. Kanë gjatësi deri në disa km, gjerësi mesatare rreth 15 m, ndërsa thellësia arrin deri në disa dhjetëra metra. Janë formuar nga erozioni i përroit të Nivicës, pjesë e atij të Bënçës, në shkëmbinjtë gëlqerorë. Shpatet e kanionit janë vertikale, kanë guva e shpella karstike shumë të vështira për t'u eksploruar. Kalimi përgjatë fundit të kanionit është i vështirë, pasi ka edhe pragje me lartësi deri disa metra. Pamja e tyre madhështore, gjelbërimi në të dy anët e tyre, i bëjnë ata tërheqës. Kanë vlerë shkencore (gjeomorfologjike, gjeologjike), didaktike e turistike. Vizitohen sipas rrugës automobilistike Tepelenë – Progonat – Nivicë.

Vjosa

Lumi i Vjosës është lumi më i madh i Shqipërisë Jugore dhe një ndër lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë, sidomos për sa i përket prurjeve të shumta ujore. Gjatësia e këtij lumi është 272 km, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës 6706 km², prej të cilit, 4365 km² janë brenda territorit tonë, ndërsa pjesa tjetër në territorin grek. Degët kryesore të Vjosës janë: Sarandoporo, Drinos dhe Shushica. Në Vjosë ose në degët e saj përfundojnë edhe shumë burime karstike si ato të grykës së Këlcyrës, të Libohovës, të Viroit, të Gjirakstrës, të Ujit të Ftohtë të Tepelenës, të Poçemit etj. Vjosa buron nga malet e Pindit (Greqi) ku rrjedh nëpër një luginë të thellë, e cila zgjerohet pasi hyn në territorin tonë. Kjo është një pjesë e Shqipërisë sonë, e cila të befason me gjithçkanë e saj. Vlerat e saj historike dhe kulturore janë të pakrahueshme me askënd tjetër sepse janë unike dhe krenari kombëtare.



KRIJIMI I USHTRISË KOMBËTARE SHQIPTARE NGA QEVERIA E PËRKOHËSHME E VLORËS (1912-1914)



NGA SALI ONUZI

Sigurimi i Kuvendit kombëtar dhe i veprimtarisë së Qeverisë kërkonin organizimin e forcave të armatosura. Për këtë qëllim, Ismail Qemali që më 26 nëntor formoi një komision organizues dhe u dërgoi pleqësive të fshatrave një qarkore me anën e së cilës porositeshin të mobilizonin njerëzit e aftë për armë dhe t'i mbanin ata në gatishmëri. Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi Qeverinë e përkohshme dhe Ismail bej Vlorën kryeministër. Po atë ditë u zgjodh Ministër i Luftës Mehmet Pashë Daralla. Nga struktura dhe përbërja e Ministrisë së Luftës njohim pozicionin e zëvendësministrit të Luftës, në të cilin u caktua Xhelal Koprencka dhe të disa komandantëve ushtarakë, si Isa Boletini, Hajredin bej Cakrani, Riza bej Gjakova etj. Pas formimit të saj, Qeveria dërgoi një forcë të vogël të armatosur me vullnetarë patriotë (vullnetarë kosovarë) të ruanin bregun e Vjosës. Ajo ngriti komisione të mbrojtjes kombëtare nëpër krahina dhe urdhëroi mobilizimin e batalioneve redif e mustafëz për mbrojtjen nga forcat greke që kishin ardhur deri në Himarë. Kërkesa e saj për të çarmatosur ushtarët turq në Myzeqe e për të armatosur ushtarë shqiptarë nuk u pranua, as nga Turqia e as nga Austro-Hungaria e Italia.

Në janar 1913, Qeveria kish ngritur dhe armën e Xhandarmërisë, e cila në fund të vitit numëronte 4 detashmente me nga 300 xhandarë secili. Më 5 maj 1913, Qeveria e Përkohëshme e Vlorës do miratonte Rregulloren për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës.

Në përbërje të Ministrisë së Luftës do të ishte Shtabi Madhor dhe Major Ali Shefqeti do të emërohej në detyrën e Kryetarit të këtij Shtabi.

Rregullorja kërkonte që, deri sa të bëhej Organizmi themelor, Qarqet e Shtabit Madhor do të vepronin si një Komision, i cili do të studionte projektet që do t' i paraqiteshin, të cilat edhe mund t' i ndryshonte dhe, bashkë me raportin përkatës, do t' ia kalonte Qeverisë nëpërmjet Ministrisë së Luftës. Kështu vetë Shtabi Madhor vepronte në fillimet e tij si një Komision (Qark). Kjo del dhe nga vula që ai përdorte: Qarku i Shtabit Madhor (1913) në një shkresë të firmosur nga Kryetari i Shtatmadhorisë Ali Shefqeti. Ky është padyshim një tregues i gjendjes së vështirë financiare, në mos edhe i mungesës së kuadrove përkatës, të cilët duhej të qenë të diplomuar si oficerë Shtabi. Në Vlorë ishin paraqitur e vënë në dispozicion të Qeverisë 70 oficerë dhe 150 nënoficerë shqiptarë. Shtabi Madhor do të hartonte edhe projekt-detyrat e raportet e Zyrave të tjera, të cilat ai i konsultonte me to (ndryshoheshin kur duhej), i parapëlqente (ose jo) dhe ia kalonte gjithashtu Ministrisë së Luftës. Fakti që Ministria e Luftës e shtetit të ri shqiptar u konceptua dhe u ndërtua me Shtab Madhor, që më 1913, tregon se ndërtimi i Ushtrisë së rregullt filloi nga lart poshtë, karakteristikë për një shtet ligjor, modern.

Rregullorja e përkohshme e Ministrisë së Luftës në një 7 të saj përcaktonte se "Do të ishin në veprimin (ligjet) e Turqisë deri sa të radhiteshin (ligjet) dhe rregulloret e reja." Kjo ndodhi edhe në organizimin ushtarak, ku mbet në fuqi dhe u zbatua ligji për mobilizimin e redifëve (rezervistëve) dhe mustafëve (forca vendore territoriale) që kishin qenë para shpalljes së Pavarësisë. Këto batalione u mobilizuan dhe luftuan kundër reparteve të ushtrisë greke që po përparonin në Shqipërinë e jugut. Në krye të tyre në terren ndodhej Xhelal Koprencka (firmëtar i Pavarësisë) zëvendësministri i Ministrisë së Luftës. Komandantë të batalioneve me redifë (rezervistë) ose mustafëz (territorial) ishin vetë bejlerët, të zotët e bujqve ushtarë, që veç komandimit, përgjigjeshin edhe për logjistikën në ndërrimin e batalioneve në front. Hajredin bej Cakrani, njëri nga firmëtarët e deklaratës së Pavarësisë dhe feudal i madh nga Cakrani i Mallakastrës, që kishte mbaruar studimet e larta ushtarake në Stamboll, ai kishte qenë para 28 nëntorit dhe ishte edhe pas tij, komandant i batalionit 'mustafëz' të Lushnjës, plus dhe komandant i operacionit qeveritar në front kundër grekëve.



Për këto reparte dhe veprimtarinë e tyre pothuajse nuk bëhet fjalë në tekstet e historisë, por ato shkrihen e shihen thuajse të gjitha si "forca vullnetare", kur në fakt ato kishin detyrim ligjor, po se po patriotik, të shërbenin e luftonin, siç edhe bënë një pjesë e mirë e tyre, batalionet e Beratit, Mallakastrës, Skraparit, Tepelenës, Përmetit, Leskovikut e Gjirokastrës, në jug kundër pushtuesve grekë dhe në Shkodër redifët dhe mustafëzët nga Shqipëria e Mesme, (Shijaku, Tirana, Kavaja e Elbasani) dhe nga Shkodra e Dibra, kundër pushtuesve malazezë.

Por në praktikë nuk shkonte gjithçka siç shkruhej. Ministri i Luftës Mehmet Pashë Deralla, më 31 janar 1914, i shkruante komandës së bylykut të Dukatit që të dërgonte emrat e 57 redifëve (rezervistë) që ishin nisur për të patur nën këqyrje pozitën e Llogorasë dhe, siç kish raportuar ajo vetë, ishin arratisur. Me 2 shkurt komandanti i batalionit Alem Mehmeti njoftonte se atje nuk kish mbetur asnjë redif. Edhe komandanti i batalionit mustafëz, Sadullai i shkruante, më 7 dhjetor 1912, Ministrisë së Luftës se 200 ushtarët që pati, 100 në Delvinë e 100 në Sarandë, ishin arratisur nga mungesa e ushqimit dhe ai ishte kthyer në Tepelenë vetëm me ordinancën e tij Kajmekani i Vlorës Mustaf Asimi njoftonte, më 15 dhjetor 1912, se ushtria popullore që ndodhet në anë të Mesaplikut ka mungesa municioni e ushqimi, e sidomos rregulli e disipline, dhe... armiku iu bën thirrje për dorëzim. Sidoqoftë këto mangësi nuk e zhvlerësojnë punën që ishte bërë për krijimin

e ushtrisë dhe veprimin e saj në terren.

Përpjekjet e Qeverisë vijnë më tej. Kryetari i Shtabit Madhor Ali Shefqeti (Shkupi), më 3 qershor 1913, i përcjell për studim Ministrin të Punëve të Brendshme, Myfit bej Libohovës, variantin e parë të rregullores së Milicisë shqiptare, para se të bisedohej në Këshillin e Ministrave. Kjo Rregullore sot gjendet në Arkivin e shtetit shqiptar, si një dëshmitare e punës së Shtabit madhor të atëhershëm, madje edhe është botuar e bërë publike. Edhe konsulli austro-hungarez Lejhaetz, njoftonte Vjenën se Zyra (e Shtabit Madhor) hartoi "Rregulloren mbi formimin e Milicisë shqiptare", sipas të cilës kjo e fundit duhej të ishte një forcë e organizuar, e ngritur mbi bazën e detyrimit ushtarak të përgjithshëm dhe që kishte për detyrë mbrojtjen e vendit deri sa të krijohet një ushtri e rregullt".

Më pas del Urdhri për formimin e Kompanisë këmbësore model të ushtrisë, ku shtrohet edhe nevoja e fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Nga informacioni i konsullit Lejhanetz del se "administrata ushtarake shqiptare kishte ndërmend të bënte më parë studime mbi sistemet e ndryshme ushtarake europiane, pastaj, të vendoste ose të merrte njërin prej tyre ose të krijonte një sistem të ri, të vetin, që u përshtatej kushteve të vendit. Prandaj konsulli i përcillte Vjenës lutjen e kësaj administrate për t' i vënë sa më shpejt në dispozicion një numër librash shërbimi lidhur me organizimin, stërvitjen dhe shërbimin e brendshëm të armëve





të ndryshme të ushtrisë..., si këmbësoria, kalorësia, artileria, xhenioja, prapavija dhe shëndetësia “

Në fakt brenda 26 ditëve nga krijimi i Shtabit, më 31 maj 1913, Kryetari i tij informonte ministrinë e Luftës, mbi punën që po bëhej për krijimin e kompanisë model të Ushtrisë, sipas të cilës do të ndërtohej Ushtria Kombëtare. Aty shtrohej edhe nevoja e fillimit së afërmi të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Më 4 shtator, gazeta Dielli në SHBA shkruante se “Qeveria mbledh ushtarë me 240 grosh në muaj, jo me pahir, po cili do vetë. ... Flitet se Guberna shqiptare do të mbledhë gjer në 20 mijë veta, të cilët do të jenë të veshur, mbathur dhe armaturë mirë, me topa, mitraloza dhe municione etj. Në arkivin e shtetit ruhet edhe një foto e kompanisë model të krijuar me emrat e oficerëve të tyre. Po në “Dielli”, më 31 tetor 1913, me burim nga Vlorë njoftoj se: “në Vlorë janë tre taborë ushtarë të Shqipërisë të veshur, të mbathur e të armaturë dhe të stërvitur mirë, me topa etj.”.. Janë edhe 7 çeta shqiptare (pra vullnetare) të organizuara fare mirë, të cilat kanë që me 300-500 njerëz njëra. Kryetarët e çetave janë këta: Mehmet Pavari, Nexhip Bënja, Salih Butka, Dino Çiçi Gjinokastrë, Namik Delvina, kapedan Spiro Korça dhe Çerçiz Topulli”.

Me detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor, major Ali Shefqeti komunikonte me telegraf dhe transmetonte vendime të Qeverisë apo urdhra e udhëzime të Ministrisë së Luftës e të vetë Shtabit për veprime luftarake, dërgim oficerësh, armatimi e municioni në territore të ndryshme të vendit, në jug kundër forcave pushtuese greke dhe në Dibër, ku po zhvillohej kryengritja e shtatorit të vitit 1913. Shtabi i drejtuar prej tij i kish sugjeruar Qeverisë dhe ajo kishte porositur jashtë shtetit, sidomos në Austro-Hungari, topa, mitraloza, uniforma, dhe ajo që të befason, edhe “një numër librash shërbimi dhe veprash të ndryshme që do t’i shërbenin administratës ushtarake të Qeverisë.”

Që më 1913, Shtabi Madhor i pat hyrë një punë të veçantë për terminologjinë ushtarake. Për këtë çështje ai pat angazhuar një komision të posaçëm në të cilin bënë pjesë oficerë të kulturuar si Mustafa Maksuti dhe Kamber Sejdiu (dëshmor i atdheut nga Elbasani) ish-profesor i frëngjishtes në gjimnazin ushtarak të Manastirit. Veprimtarisë së këtij komisioni i takojnë shumë terma që përdorim sot në fushën ushtarake.

Por puna e Qeverisë së Vlorës për Ushtrinë do të vështirësohej pas Vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 29 korrikut 1913, i cili ndonëse njihje shtetin shqiptar, (nën garancinë e Fuqive të Mëdha), e vinte atë nën kontrollin e një Komisioni Ndërkombëtar që ngarkohej për organizimin e gjithë degëve të administratës civile (por jo dhe asaj ushtarake) ashtu siç caktoi oficerë të huaj për organizimin vetëm të xhandarmërisë. Efektet negative të mungesës së organizimit ushtarak do të ndjeheshin fort në ngjarjet tronditëse e tragjike të vitit 1914, ndërkohë që garancia e Fuqive të Mëdha u shkri si kripa në ujë.

Historiografia zyrtare shqiptare nuk e ka evidentuar dhe vlerësuar sa duhet veprimtarinë ushtarake të Qeverisë së Vlorës. Prof. Arben Puto në “Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914”, i referohet vetëm konsullit Lejhanetz për një “zyrë të shtatmadhorisë, që me nënvlefësim e quante njëllor organ ushtarak i Qeverisë së përkohëshme, kur ai ishte një organ

i vërtetë ushtarak. Për më keq, teksti i Akademisë ushtarake i vitit 1986 as nuk e përmend këtë “Zyrë shtatmadhorie”. Prof. Arben Puto, konkludon se Qeveria e Vlorës mori disa masa organizative paraprake, por nuk arriti asnjëherë të krijonte as dhe bërthamën e një ushtrie kombëtare. Ndërsa teksti akademik i Historisë i vitit 2002 ripërsërit konsullin austriak dhe e quan krijimin e një ushtrie të rregullt një “objektiv i parakohshëm, i parealizueshëm në ato rrethana. Po këtë shkruan edhe “Historia e popullit shqiptar gjatë shekullit të XX”. Ky mendim për administratën ushtarake nuk na duket bindës dhe mendojmë se duhet hetuar e diskutuar më tej. Në kujtimet e tij Ismail Qemali shkruan se: “si u ktheva (nga Londra, S.O) në Vlorë në qershor 1913 Qeveria e përkohëshme i dyfishoi përpjekjet për organizimin e vendit dhe për ruajtjen e rendit. Mund të ishin qajtur fare mirë detyra të pamundëshme për t’u kryer, por punën e bënte më të lehtë karakteri i shqiptarit-durimin, maturinë dhe patriotizmin e paepur të të cilit, mes gjithë atyre ngatërresave e hallevë, nuk ka fjalë e lëvdatë që ta përshkruajë. Pikërisht falë virtyeteve të kësaj race...qeveria ime ia doli mbanë t’i sjellë stabilitet shtetit dhe të siguroje një administratë normale. Krijimi i Ministrisë së Luftës, i Shtabit Madhor, i bazës ligjore e normative krijimi i xhandarmërisë, mobilizimi në luftë i disa batalioneve redif e muztafëz, plus tri kompanive me nizamë shqiptare, krijimi i një kompanie model të ushtrisë së rregullt dhe, nën shembullin e saj të tre batalioneve me ushtarë aktiv, dhe një grupi me 120 kalorës, a nuk përbënin këto një bërthamë të ushtrisë së rregullt,



apo një ushtri të vogël në numër? Kjo veprimtari nuk mbeti vetëm në disa masa organizative paraprake. Ngritja e Ushtrisë së rregullt dhe asaj të përhershme ishin një nevojë e kohës, por ato nuk u realizuan sipas parashikimeve, për shkak të kushteve shumë të vështira në të cilat u detyrua të vepronte Qeveria, të mosnjohjes së saj nga përfaqësuesit e fuqive të mëdha si qeveri kombëtare e të ndërhyrjeve të tyre të padrejta. Qeveria e Vlorës vepronte në një territor të lirë, të çliruar dhe në kushte lufte me pushtues të egër. Ajo nuk kish pse të vonohej, forcat ushtarake ishin një detyrë urgjente e kohës dhe ajo iu përgjigj asaj me sa mundësi pati. Ndërkohë duhet shënuar se batalionet me redifë dhe ato mustafëz, brenda territorit ku shtrinte veprimtarinë e saj Qeveria e Vlorës në fakt i përkisnin një ushtrie të rregullt, pse ishin organizuar mbi bazën e ligjit ushtarak, me organika standard, për moshën e pjesëmarrësve, numrin e tyre, komandën, uniformën dhe armët që i mbanin në magazinat e ushtrisë etj. Fakti që nuk ishin forca aktive, të përhershme, d.m.th. nizamë, apo ushtarë aktiv, nuk i bën ato ushtri (forcë) e parregullt. Ato edhe sot janë pjesë e Forcave të armatosura në katër anët e Botës. Shtu këtu dhe faktin që Qeveria kishte vendosur, më 13 janar 1913, dhe realizoi krijimin e armës së xhandarmërisë.

Kujtojmë se xhandari i vitit 1913 ishte edhe ruajtës i rendit edhe ushtar i luftës, një forcë ende e pa diferencuar. Pra ishte pjesë e ushtrisë së rregullt. Prandaj edhe në përbërjen e Shtabit Madhor kishte një Komision të trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë. Diferencimi i kësaj arme, ndarja e xhandarmërisë nga policia dhe ushtria u bë më vonë, deri në vitin 1920. Krijimi i ushtrisë nga Qeveria e Ismail Qemalit është regjistruar edhe në raportet e dy oficerëve të huaj, kapitenit austriak Ulmansky dhe gjermanit Claner, të cilët siç shkruan prof. as. dr. Marenglen Kasmi, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë dyjavore në Shqipëri. Kapiteni Ulmansky vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që kapiteni Claner vizitoi Shqipërinë e Jugut. Raporti që ata hartuan mbi vizitën e tyre në Shqipëri është jo vetëm tepër i hollësishëm dhe të krijon bindjen e një analize të thellë dhe të kujdesshme për gjendjen e shoqërisë shqiptare në prag të ardhjes së Vidit, si për situatën politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë”. Dy kapitenët në raportin e tyre shkruajnë: “Qeveria e Ismail Qemalit, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, ishte më e veçantë. Ajo konsiderohej si Qeveria zyrtare e Shqipërisë dhe mbante lidhje diplomatike me qeveritë europiane. Në të vërtetë ndikimi i saj shtrihej vetëm në qytetin e Vlorës dhe në territoret e afërta të qytetit. Qeveria, shkruajnë autorët, kishte xhandarmërinë e saj dhe, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, (nënvizimi im, S.O) kishte një forcë ushtarake, me një ministri lufte si dhe një shtab madhor që drejtonte ushtrinë, e cila gjithsesi ishte në fazën e saj të formatimit. Krahasuar me qeveritë e tjera lokale, ajo e Vlorës kishte të ardhurat më të mira si pasojë e vjeljes së taksave portuale... Brenda vendit mbizotëronte një farë qetësie e rregulli dhe të huajt mund të udhëtonin pa probleme. Po ashtu shërbimi postar dhe ai telegrafik funksiononte në të gjithë vendin.

Ky raport i dy kapitenëve austro-hungarez e gjerman, nga dy vende të njohura për organizimin modern ushtarak në Europë, dhe përfundimi i tyre se Qeveria e përkohëshme e Vlorës kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, mendojmë se vlen shumë për çështjen që po trajtojmë dhe mund të themi se i vë kapak asaj. Ndërkohë, nuk duhet të harrojmë se kjo ushtri nuk ishte një ushtri evidencash dhe rrogëtarësh, por një forcë që kish luftuar e luftonte në front për të ndalur përparimin e forcave, sidomos greke, për të pushtuar Vlorën e territore të tjera nën autoritetin e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës dhe që përkrahte, aq sa kishte mundësi, edhe me oficerë, armatim e municion kryengritjen e Dibërës të shtatorit 1913.



REKRUTIM
FORCËT ARMATOSURE
TE SHQIPËRIE



REPUBLIKË
E SHQIPËRIE



**NË KËMBË
PËR KOMBIN!**